

Të dhënat kryesore

| Banka Raiffeisen në Kosovë sh.a. | | | |
|--|--------------------|--------------------|-----------|
| Vlerat monetare janë në milionë euro | 2013 | 2012 | Ndryshimi |
| Pasqyra e të ardhurave | 1/1 - 31/12 | 1/1 - 31/12 | |
| Të ardhurat neto nga interesi pas provizioneve | 33.5 | 32.6 | 2.6% |
| Të ardhurat neto nga tarifat | 8.0 | 7.8 | 2.1% |
| Profiti tregtar | 0.1 | 0.1 | -31.6% |
| Rezultati neto i vlerësimit të instrumenteve financiare në VD | 0.8 | (0.6) | -240.2% |
| Vlerësimi neto i investimeve në ekuitet | - | 0.5 | -100.0% |
| Të ardhura tjera operative | 0.1 | 0.1 | 63.1% |
| Shpenzimet e përgjithshme administrative | (25.5) | (26.4) | -3.5% |
| Fitimi para tatimit | 17.0 | 14.2 | 19.9% |
| Fitimi pas tatimit | 15.2 | 12.6 | 20.7% |
| Fitimet për aksion | N/A | N/A | N/A |
| Bilanci i gjendjes | | | |
| Kreditë dhe paradhëniet e dhëna bankave | 63.2 | 46.1 | 37.1% |
| Kreditë dhe paradhëniet e dhëna klientëve | 432.3 | 401.1 | 7.8% |
| Kreditë tjera | 19.3 | 20.9 | -7.4% |
| Depozitat dhe huamarrjet nga bankat | 4.5 | 4.2 | 7.8% |
| Depozitat nga klientët | 557.7 | 513.9 | 8.5% |
| Ekuiteti (përfsh. pakicën dhe profitin) | 107.0 | 99.2 | 7.8% |
| Gjithsej bilanci i gjendjes | 698.1 | 628.5 | 11.1% |
| Informatat vendore rregullative | | | |
| Pasuritë e ponderuara sipas riskut B1, përfsh. riskun e tregut | 504.4 | 490.5 | 2.8% |
| Gjithsej fondet vetanake | 86.9 | 67.1 | 29.6% |
| Gjithsej kërkesa për fondet vetanake | 60.5 | 58.9 | 2.8% |
| Raporti i mbulimit tepricë | 43.6% | 14.0% | 29.6 PP |
| Raporti i kapitalit kryesor (Klasi 1) | 12.4% | 12.7% | -0.3 PP |
| Gjithsej raporti i fondeve vetanake | 17.2% | 13.7% | 3.5 PP |
| Performanca | | | |
| Kthimi në ekuitet (KE) para tatimit | 17.6% | 15.8% | 1.8 PP |
| Kthimi në ekuitet (KE) pas tatimit | 15.8% | 14.1% | 1.7 PP |
| Raporti kosto/të ardhura | 54.5% | 58.3% | -3.8 PP |
| Kthimi në pasuri (KP) para tatimit | 2.6% | 2.2% | 0.4 PP |
| Raporti neto i provizioneve (pasuritë mesatare të ponderuara sipas riskut B2 në librin e bankës) | 0.9% | 1.1% | -0.2 PP |
| Raporti risk/fitime | 11.2% | 12.7% | -1.5 PP |
| Burimet | | | |
| Numri i punëtorëve | 684 | 675 | 1.3% |
| Numri i degëve dhe nëndegëve | 52 | 50 | 4.0% |

Përmbajtja

| | |
|---|-----------|
| Raport nga Bordi Mbikëqyrës | 4 |
| Raport nga Bordi Menaxhues | 5 |
| Bordi Menaxhues i Bankës Raiffeisen në Kosovë | 6 |
| | |
| Struktura organizative | 7 |
| Vizioni dhe misioni | 8 |
| Shkurtimisht mbi Raiffeisen Bank International | 9 |
| | |
| Mjedisi makroekonomik në Kosovë | 10 |
| Pozicionimi i Bankës Raiffeisen në tregun bankar të Kosovës | 12 |
| | |
| Thesari | 17 |
| | |
| Korporatat | 18 |
| Afarizmi bankar me korporata | 18 |
| Zhvillimi i produkteve për korporata | 18 |
| Ndërmarrjet e vogla | 19 |
| | |
| Biznesi retail | 20 |
| Mikro bizneset | 20 |
| Individët | 20 |
| Menaxhimi dhe zhvillimi i produkteve | 20 |
| Kanalet e distribuimit | 21 |
| Shërbimi për klientë | 21 |
| | |
| Menaxhimi i kredive dhe riskut | 22 |
| Operacionet | 22 |
| Teknologjia e informacionit dhe kompjuterëve | 24 |
| Menaxhimi dhe trajnimi i personelit | 24 |
| | |
| | |
| Pasqyrat financiare | 26 |
| | |
| Fjalorthi i Raiffeisen | 66 |
| | |
| Grupi RBI në Evropë | 67 |
| | |
| Adresat dhe kontaktet | 68 |

Raport nga Bordi Mbikëqyrës

Zonja dhe zotërinj,

Pas vjetëve të rritjes dukshëm të ngadaltë apo në raste te caktuara edhe negative, viti 2013 më në fund ka treguar shenjat e para të një rimëkëmbjeje ekonomike si në Eurozonë ashtu edhe në Evropën Qendrore dhe Lindore. Kemi parë edhe një zhvendosje gjithnjë e më shumë të rritjes ekonomike drejt Evropës Qendrore me Poloninë, Republikën Çeke dhe Sllovakinë që po marrin rol udhëheqës në rajon. Përveç kësaj, vendimet politike për të ardhmen e Unionit Bankar Evropian janë marrë më në fund dhe mundësojnë më shumë qartësi për sektorin bankar evropian. Megjithatë, mjedisi i biznesit për bankat mbetet i vështirë. Veçanërisht ngritja afatshkurtër e kërkesave për kapital dhe kërkesat e ndryshme komplekse rregullative, si dhe taksat bankare, kanë qenë dhe vazhdojnë të jenë një barrë shtesë për bankat, duke çuar në kufizim të dhënies së kredive.

Në vjeshtën e vitit 2013, Grupi RBI filloi programin “Gati për të ardhmen 2016”, me qëllimin që deri në vitin 2016 të ulë shpenzimet sa ishin në nivelin e vitit 2012. Kjo do të thotë se gjatë tri viteve të ardhshme ne synojmë ta kompensojmë inflacionin dhe të kursejmë rreth 450 milionë euro në total. Ishim gjithashtu shumë të kënaqur me 2.78 miliardë euro si rezultat i rritjes së kapitalit në kohët e fundit. Numri më i madh i aksioneve në shitje të lirë i bën aksionet tona edhe më atraktive si për investitorët privatë ashtu edhe ata institucionalë. Kjo do të përdoret për të arritur qëllimin tonë, që brenda 12 – 18 muajve të ardhshëm, të arrijmë një koeficient të plotë në Basel III CET 1 prej 10.0 për qind deri në fund të periudhës së tranzicionit. Të dy veprimet janë marrë për të përkrahur modelin tonë të suksesshëm të biznesit në të gjithë rajonin dhe për të garantuar një zhvillim të qëndrueshëm të Grupit në këtë mjedis ende sfidues. Prandaj, Grupi RBI është krenar që regjistron profit para tatimit prej 835 milionë euro.



Sa i përket bankës Bankës Raiffeisen në Kosovë, jemi të kënaqur që raportojmë se ka vazhduar të arrijë rezultate shumë të mira në vitin 2013. Mjedis i përgjithshëm makroekonomik në Kosovë ishte stabil dhe edhe një herë vendi shënoi rritjen më të lartë të Bruto Produktit Vendor (BPV) në rajon me 3 për qind. Duhet të theksohet se sektori bankar në Kosovë ka shënuar një tjetër vit shumë të kënaqshëm sa i përket profiitit dhe treguesve të tjerë kryesorë të performancës. Banka Raiffeisen në Kosovë ka kontribuar mjaft në zhvillimin pozitiv të sektorit bankar. Përveç rritjes së profiitit, kredive, depozitave dhe totalit të pasurive, Banka Raiffeisen në Kosovë ka ulur koeficientin të ardhura/shpenzime nga 58 për qind në 2012 në 54.5 për qind në vitin 2013. Gjithashtu ka rritur numrin e përdoruesve të shërbimeve bankare elektronike për më shumë se 50 për qind dhe ka investuar në mënyrë të konsiderueshme në përmirësimin e shërbimit për klientë.

Më lejoni të përfitoj nga ky rast të falënderoj të gjithë punëtorët e Bankës Raiffeisen në Kosovë për punën e tyre të madhe në këtë mjedis vazhdimisht të vështirë dhe përpjekjet e tyre të vazhdueshme për t’u shërbyer klientëve tanë dhe për të sjellë përfitime për tërë grupin Raiffeisen.

Në emër të Bordit Mbikëqyrës,

Helmut Breit
Kryesues i Bordit Mbikëqyrës

Raport nga Bordi Menaxhues

Viti 2013 ka qenë një vit i shkëlqyer për Bankën Raiffeisen në Kosovë. Mjedisi makroekonomik i vendit ishte më i mirë se në shumë vende të tjera të Evropës Jug-Lindore. Kjo kontribuoi që Banka të arrijë sukses në të gjithë treguesit kryesorë pozitivë të performancës në vitin 2013, duke përfshirë profitin neto pas tatimit prej 15.2 milionë euro që paraqet një rritje prej 21 për qind krahasuar me vitin 2012.

Megjithëse kemi pasur një qasje të matur dhe të arsyeshme ndaj kredidhënies në të gjitha segmentet e klientëve, pasuritë tona kanë vazhduar të rriten gjatë vitit 2013. Portfolio e përgjithshme kreditore arriti shumën prej 432 milionë euro deri në fund të vitit, një rritje prej 8 për qind nga viti 2012. Në të njëjtën kohë, portfolio e bankës sonë është portfolio më e madhe e kredive në sektorin bankar të Kosovës. Qasja jonë e kujdesshme ndaj kredidhënies është pasqyruar në cilësinë e shkëlqyeshme të portfolios së kredive, dhe provizionet tona të reja kreditore janë rritur vetëm për 4.4 milionë euro, rritja më e ulët që kemi pasur në vjetët e fundit. Depozitat e klientëve tanë janë rritur për 9 për qind në vitin 2013 në një shumë totale prej 558 milion euro. Kjo rritje është një demonstrim i qartë i besimit që klientët e kanë në brendin tonë dhe konfirmon se janë të kënaqur me shërbimet tona të degës dhe rrjetin e shpërndarjes. Menaxhimi i kostos dhe efikasiteti i përmirësuar ishin gjithashtu prioritete të larta në vitin 2013 dhe me kënaqësi raportoj se koeficienti të ardhura/shpenzime është zvogëluar nga 58 për qind në vitin 2012 në 54.5 për qind në vitin 2013.



Një tjetër prioritet ishte zhvillimi i shërbimeve tona elektronike bankare në fusha të tilla si në bankomatet, terminalët e pikave të shitjes, shërbimeve bankare në internet dhe ato telefonike. Kemi përmirësuar funksionalitetin dhe kemi ofruar qasje më të mirë në këto shërbime në tërë Kosovën, dhe si rrjedhojë edhe përdorimi i shërbimeve elektronike nga klientët tanë është rritur ndjeshëm. Për shembull, numri i klientëve që përdorin shërbimet tona bankare përmes internetit është rritur për 53 për qind ndërsa numri i transaksioneve në terminalët e pikave të shitjes është rritur për 9 për qind në krahasim me vitin 2012. Zhvillimi i mëtejshëm i këtyre shërbimeve do të vazhdojë të jetë prioritet në vitin 2014, si pjesë e qëllimit tonë për të bërë shërbimet bankare të përshtatshme dhe të arritshme për të gjitha pjesët e vendit në çdo kohë të ditës.

Viti 2013 do të mbahet mend edhe si një vit shumë i veçantë, sepse kemi festuar dhjetëvjetorin e punës së Bankës sonë në Kosovë. Jemi shumë krenarë për atë që e kemi arritur gjatë dekadës së fundit, duke kontribuar kështu edhe në rritjen dhe zhvillimin e ekonomisë së Kosovës.

Gjithashtu me kënaqësi raportoj se rezultatet tona të shkëlqyera gjatë vitit 2013 janë vlerësuar edhe përmes çmimit "Banka më e mirë në Kosovë", çmim të cilin revista e njohur ndërkombëtare "The Banker" e ka ndarë për Bankën Raiffeisen në Kosovë.

Përfundimisht, në emër të Bordit Menaxhues dëshiroj të falënderoj të gjithë punonjësit tanë për arritjen e një tjetër viti të shkëlqyer. Asnjë nga këto rezultate nuk do të ishte e mundur pa aftësitë e tyre, besnikërinë, angazhimin dhe përkushtimin dhe janë pikërisht ata që më japin besim absolut se edhe viti 2014 do të jetë një vit shumë i suksesshëm.

Në emër të Bordit Menaxhues,

Robert Wright
Kryesues i Bordit Menaxhues

Bordi Menaxhues i Bankës Raiffeisen në Kosovë



Robert Wright

Kryesues i Bordit
Menaxhues



Shukri Mustafa

Anëtar i Bordit
Menaxhues



Iliriana Toçi

Anëtare e Bordit
Menaxhues




Johannes Riepl

Anëtar i Bordit
Menaxhues

Struktura organizative e Bankës Raiffeisen në Kosovë

deri më 31 dhjetor 2013



*Auditori i brendshëm i raporton drejtpërdrejt Komitetit të Auditimit të Bordit Mbikqyrës

Vizioni dhe misioni i Bankës Raiffeisen në Kosovë

Vizioni

Të jetë banka kryesore dhe universale në Kosovë.

Misioni

Të zhvillojë marrëdhënie afatgjata me klientë duke ju ofruar një gamë të gjerë të produkteve konkurruese dhe shërbime të një standardi të lartë.

Të jetë punëdhënësi më i mirë.

Shkurtimisht mbi Raiffeisen Bank International

Bankë udhëheqëse në Evropën Qendrore dhe Lindore, duke përfshirë edhe Austrinë

Banka Raiffeisen në Kosovë është degë e Raiffeisen Bank International AG (RBI), e cila e konsideron Evropën Qendrore dhe Lindore (duke përfshirë Austrinë), si treg të saj. Për më shumë se 25 vjet, RBI ka vepruar në rajonin e Evropës Qendrore dhe Lindore (EQL), në të cilin sot ka një rrjet të fuqishëm të bankave, kompanive për lizing dhe kompanive që ofrojnë shërbime të specializuara financiare në 15 tregje. Si një bankë universale, RBI renditet ndër bankat kryesore në rajon. Roli i fuqishëm që e luan banka përkrahet nga brendi Raiffeisen, që është një prej emrave më të njohur në rajon. Me kalimin e kohës, RBI është shndërruar në një grup bankar plotësisht të integruar në afarizmin bankar me korporata dhe shitje me pakicë (retail) në EQL. RBI gëzon jo vetëm qasje të mirë të klientët retail dhe korporatat, por edhe dallohet me ofertë gjithëpërfshirëse të produkteve. Në fund të vitit 2013 rreth 55,000 punonjës i kanë shërbyer rreth 14.6 milionë klientëve në rreth 3,000 zyra të biznesit në EQL.

Në Austri, RBI është një nga bankat kryesore të korporatave dhe të investimeve. Ajo kryesisht u shërben klientëve austriakë, por edhe ndërkombëtarë si dhe korporatave ndërkombëtarë që veprojnë në EQL. Për më tepër, RBI është e përfaqësuar në qendrat financiare botërore dhe ka degët dhe zyrat përfaqësuese në Azi. Në përgjithësi, RBI punëson rreth 58,000 punonjës dhe ka pasuri totale prej rreth 131 miliardë euro.

RBI ka banka vartëse në këto tregje të EQL:

| | |
|--------------------------|--|
| • Shqipëri | Raiffeisen Bank Sh.a. |
| • Bjellorusi | Priorbank JSC |
| • Bosnjë dhe Hercegovinë | Raiffeisen Bank d.d. Bosna i Hercegovina |
| • Bullgari | Raiffeisenbank (Bulgaria) EAD |
| • Kroaci | Raiffeisenbank Austria d.d. |
| • Republikën Çeke | Raiffeisenbank a.s. |
| • Hungari | Raiffeisen Bank Zrt. |
| • Kosovë | Banka Raiffeisen në Kosovë J.S.C. |
| • Poloni | Raiffeisen Bank Polska S.A. |
| • Rumani | Raiffeisen Bank S.A. |
| • Rusi | ZAO Raiffeisenbank |
| • Serbi | Raiffeisen banka a.d. |
| • Sllovaki | Tatra banka, a.s. |
| • Slloveni | Raiffeisen Banka d.d. |
| • Ukrainë | Raiffeisen Bank Aval JSC |

Si kompania amë e këtyre bankave, pjesa e aksioneve të RBI në to është 100 përqind ose afër 100 përqind në shumicën e rasteve.

Zhvillimi i RBI

RZB është themeluar në vitin 1927 si "Genossenschaftliche Zentralbank". Raiffeisen themeloi degën e saj të parë në Evropën Qendrore dhe Lindore që në vitin 1987. Që nga atëherë janë themeluar edhe degë të tjera tjera. Nga viti 2000 e tutje, zgjerimi i Raiffeisen në vendet e EQL është arritur kryesisht duke blerë bankat ekzistuese dhe më pas duke i kombinuar ato në një kompani holding që nga viti 2003 filluan të veprojnë me emrin Raiffeisen International. Në prill të vitit 2005 Raiffeisen International u regjistrua në bursë për të financuar rritjen e saj të ardhshme në mënyrë efikase. RBI e sotme është themeluar në vitin 2010 përmes bashkimit të Raiffeisen International me fushat kryesore të biznesit të Raiffeisen Zentralbank Österreich AG (RZB).

RBI është regjistruar në bursën e Vjenës që nga data 25 prill 2005 (si Raiffeisen International deri më 12 tetor 2010). RZB, e cila funksionon si institucioni qendror i Grupit Austrian Raiffeisen Banking Group (RBG), mbeti aksionari shumicë pas bashkimit, duke mbajtur rreth 78.5 për qind të aksioneve deri më 31 dhjetor 2013. Përafërsisht 21.5 për qind të aksioneve të mbetura të RBI ishin në shitje të lirë. Për shkak të rritjes së kapitalit në fillim të vitit 2014, numri i aksioneve në shitje të lirë u rrit konsiderueshëm në rreth 39.3 për qind pasi RZB kishte hequr dorë nga të drejtat e saj të abonimit dhe kishte marrë pjesë me shumë prej vetëm 750 milionë euro. Deri në datën kur po raportojmë, RZB mban 60.7 për qind të aksioneve të RBI.

Për më shumë informata ju lutem referohuni në www.rbinternational.com dhe www.rzb.at.

Mjedisi makroekonomik në Kosovë

Shënim: Informatat në vijim bazohen në materiale të marra nga Banka Qëndrore e Republikës së Kosovës, Fondi Monetar Ndërkombëtar, Banka Botërore dhe Ministria e Financave.

Ekonomia reale

Stabiliteti makroekonomik i ekonomisë së Kosovës ka vazhduar në vitin 2013 ndërsa vendi arriti rritjen më të lartë të Bruto Produktit Vendor (BPV) në rajon me 3 për qind gjatë dy vjetëve të fundit. Konsumi privat ka qëndruar i fuqishëm gjatë gjithë vitit dhe nuk është ndikuar nga zhvillimet në Eurozonë siç është ndikuar komponenti i investimeve. Ky i fundit u rikthye nga mesi i vitit dhe deri në fund të vitit bizneset raportuan më shumë porosi në libra, që pasqyrohet në investime më të mëdha në stoqe. Parashikimet më të ndritshme e rikthyen edhe besimin e investitorëve dhe investimet e huaja direkte duken më mirë se një vit më parë. Zgjedhjet lokale në tremujorin e katërt çuan në një zgjerim të madh fiskal, në veçanti me investimet kapitale, ndërsa deficitin e përgjithshëm buxhetor mbetet në përputhje me marrëveshjen me Fondin Monetar Ndërkombëtar (FMN).

Ekonomia joformale mbetet një nga problemet kryesore për performancën fiskale, por edhe në përgjithësi për matjet e performancës së ekonomisë në tërësi. Mungesa e të dhënave për këtë segment ekonomik do të thotë se madhësia e tij mund të vlerësohet në 40 për qind të ekonomisë së përgjithshme. Përveç kësaj, edhe papunësia mbetet një nga sfidat kryesore.

Norma e inflacionit ka shënuar trend vazhdimisht në rënie gjatë gjithë vitit. Viti filloi me 3.6 për qind në vit dhe përfundoi me 0.5 për qind, mesatarisht 1.8 për qind.

Sektori bankar

Sektori bankar është zhvilluar pozitivisht në vitin e fundit, pasuritë u rritën për 230 milion euro duke arritur shifrën prej 3.1 miliard euro. Shtytësi kryesor i rritjes nuk ishin kreditë, të cilat u rritën vetëm për 42 milionë euro brenda vitit pas një rënieje të papritur në korrik dhe gusht, por letrat me vlerë të cilat shtuan 98 milionë euro. Provizionet për humbjet dhe paradhëniet janë rritur për 16 për qind sipas rregulloreve të BQK-së. Edhe pse të ngjashme në vëllim, kreditë për klientët individualë janë ofruar me një normë dyfish më të lartë sa kreditë e biznesit, duke bërë që shumata e mbetura të arrijnë në 1.8 miliard euro. Pas një fillimi të dobët, depozitat u rritën ndjeshëm në muajt e fundit, duke shënuar rritje prej 170 milionë euro, ose 7 për qind, duke arritur shifrën totale prej 2.5 miliardë euro. Kjo rritje ka ndodhur me gjithë uljen e shpejtë të normave të interesit të depozitave gjatë tremujorit të fundit të vitit 2013, e cila në fakt ishte niveli më i ulët mesatar prej 2.3 për qind. Normat më të ulëta të regjistruara në Kosovë janë raportuar edhe për kreditë, të cilat mesatarisht ishin 13.6 për qind në fillim të vitit dhe përfunduan me 11.1 për qind.

Sipas Bankës Qendrore të Kosovës, në fund të vitit, industria bankare ka arritur një profit prej 26.6 milionë euro, 61 për qind e të cilit është fituar gjatë dy tremujorëve të parë, ndërkohë që tremujori i fundit ka kontribuar më së paku në shifrën totale. Duhet të mbahet mend se rregulloret e BQK-së për provizionet ndryshojnë nga standardet e IFRS, gjë e cila mund të ndryshojë dukshëm pamjen e profitit.

Zhvillime tjera

PTK (Posta dhe Telekom i Kosovës) nuk arriti të privatizohet as herën e dytë, dhe pritet që procesi të rifillojë përsëri në vitin 2014. Bonot e Qeverisë janë lëshuar për herë të parë për periudha deri në një vit, ku oferta tejkalon kërkesën, dhe ku normat e ulëta yield tregojnë besimin e tregut në buxhetimin e kujdesshëm të qeverisë.


Kjo pamje sinjalizon një vazhdim të shpenzimeve kapitale afatmesme në projekte të mëdha, në veçanti përmes projektit buxhetor të financimit të autostradës për në Shqipëri dhe projektit të ardhshëm të autostradës për Maqedoni, që do të financohet nëpërmjet një konglomerati publiko-privat.

Qeveria ka nisur edhe subvencionimin financiar dhe praktik përmes projekteve strategjike, si krijimi i pikave të grumbullimit të prodhimit bujqësor. Këto veprime do të kontribuojnë në mbulimin vendor të kërkesës së konsumatorit dhe uljen e pabarazisë tregtare për produktet ushqimore.


Bilanci i pagesave

Bilanci i llogarive të Kosovës vazhdon të jetë negativ për shkak të mungesës së tepruar të balancit tregtar të mallrave. Në fund të tremujorit të tretë deficitit ishte 244 milionë euro, që është dukshëm më i ulët se një vit më parë, për shkak të uljes së importit të mallrave dhe rritjes së eksportit. Megjithatë, komponenti i mallrave ende rritet deri në një shumë negative prej 1,471 milionë euro, gjë që kundërpeshon deri më tash të gjitha komponentët pozitivë. Transferet në llogari, të cilat kryesisht përbëhen nga dërgesat e emigrantëve arrijnë në 889 milion euro dhe është kontribuuesi më i madh i llogarisë rrjedhëse të balancuar. Shërbimet dhe të ardhurat nuk kanë treguar ndryshim nga viti i kaluar dhe janë të barabarta me 338 milionë euro.

Llogaria kapitale është 24 milionë euro, ndërkohë që, llogaria financiare është 130 milionë euro. E fundit përfshin 192 milionë euro në investimet direkte, ndërkohë që investimet e portfolios dhe investimet e tjera kompensojnë njëra-tjetrën me shumë negative prej 228 milionë euro respektivisht 244 milionë euro.



Burimi: BQK, FMN, Raiffeisen RESEARCH





Burimi: BQK, FMN, Raiffeisen RESEARCH

Pozicionimi i Bankës Raiffeisen në tregun bankar të Kosovës

Shënim: Analiza e tregut është bazuar në rezultatet e publikuara financiare të Bankave Komerciale të përgatitura në përputhje me rregullat e Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës (BQK).


Pasuritë e përgjithshme të Bankës Raiffeisen në Kosovë deri me datën 31 dhjetor 2013 ishin 698.1 milionë euro. Kjo paraqet një rritje prej 11 për qind kur krahasohet me vitin paraprak. Përqindja e tregut të pasurive të përgjithshme që Banka Raiffeisen në Kosovë mbante ishte 23.9 për qind.





Struktura e pasurive të Bankës Raiffeisen në Kosovë ka vazhduar të jetë e dominuar nga kreditë dhe paradhëniet për klientët. Deri me datën 31 dhjetor 2013, 64.7 për qind e pasurive të përgjithshme ishin të përqendruara në kredi dhe paradhënie për klientët pas provizioneve për humbjet nga kreditë. Pasi në kreditë dhe paradhëniet për bankat, duke përfshirë ekspozimin në Bankën Qendrore të Kosovës (BQK) me 15.8 për qind. Llogaria në BQK gjithashtu përfshin rezervat që kërkohen me rregulloret e BQK-së për rezervat minimale.

Letrat me vlerë për investime përfshijnë 13.7 për qind të pasurive. Letrat me vlerë të investimeve përfshijnë investimet në bonot qeveritare të shteteve të BE-së dhe SHBA, si dhe bonot e thesarit të lëshuara nga Qeveria e Republikës së Kosovës.



Totali bruto i kredive dhe paradhëniesve të Bankës Raiffeisen në Kosovë deri me datën 31 dhjetor 2013 ka qenë 456.6 milionë euro (2012: 426.5 milionë euro). Kjo është rritje prej 6.3 për qind në krahasim me vitin 2012.



Pjesa e tregut sa i përket kredive dhe paradhëniesve deri me datën 31 dhjetor 2013 ka qenë 26 për qind (2012: 25 për qind). Banka Raiffeisen në Kosovë gjithashtu ka paraparë humbjet e kredive në bazë të politikave të veta të riskut kreditor. Këto zbritje të parapara për humbjet e kredive kapin shumën 25.6 milionë euro (2012: 26.4 milionë euro).




Depozitat e klientëve në Bankën Raiffeisen në Kosovë vazhduan të rriten në mënyrë të konsiderueshme. Në vitin 2013, depozitat e klientëve ishin 557.7 milionë euro (2012: 513.9 milionë euro). Pjesa e tregut e Bankës në tregun e depozitave ishte 23.2 për qind e totalit të sektorit bankar në Kosovë.



Struktura e detyrimeve të Bankës është e dominuar nga depozitat e klientëve, që është e njëjtë me tregun e Kosovës.

Baza e depozitave është kryesisht nga depozituesit lokalë, ndërsa financimi nga jashtë, duke përfshirë bankat zhvillimore ndërkombëtare mbetet i ulët. Prodhimi vendor i financave gjithashtu kontribuon drejt stabilitetit më të madh në sektorin bankar dhe ul ndikimin e paqëndrueshmërisë në tregjet ndërkombëtare.

Norma mesatare e paguar për depozitat e klientëve në Kosovë në shtator 2013 ishte 3.5 për qind, një rënie e lehtë nga 3.7 për qind në shtator 2012. (Burimi; BQK - Vlerësimi Tremujor i Ekonomisë, Nr. 4, Tremujori III/2013)



Në vitin 2013, Banka Raiffeisen në Kosovë ka marrë edhe 19 milionë euro borxh afatgjatë shtesë në formën e borxhit të varur nga kompania e amë e tij. Ky financim është përfshirë edhe në llogaritjen e kapitalit rregullativ të Bankës të Klasit 2.




Struktura e kapitalit të Bankës Raiffeisen në Kosovë gjithashtu tregon një proporcion të lartë të kapitalit aksionar (58 milionë euro) që deri më datën 31 dhjetor 2013 ishte në shumën 54 përqind (2012: 58 përqind). Fitimet e mbajtura ishin 49 milion euro duke përfshirë shpërndarjen e dividendës prej 7.5 milion euro në vitin 2013.

Banka Raiffeisen në Kosovë mban një raport të mjaftueshmërisë së kapitalit që siguron pajtueshmërinë me rregulloren e Bankës Qendrore të Kosovës për mjaftueshmërinë e kapitalit të bankave. Sipas Rregullores së Bankës Qendrore për Mjaftueshmërinë e Kapitalit të Bankave, bankat komerciale që operojnë në Kosovë kërkohet të mbajnë një raport minimal prej 8 përqind të kapitalit të Klasit 1 dhe 12 përqind të kapitalit të përgjithshëm në raport me pasuritë e rrezikuara dhe rreziqet e tjera. Deri më datën 31 dhjetor 2013, Banka Raiffeisen në Kosovë ka pasur një raport të mjaftueshmërisë së kapitalit të Klasit 1 prej 12.4 përqind dhe një raport të fondeve vetanake totale prej 17.2 përqind.



Të ardhurat neto pas tatimit në vitin 2013 ishin 15.2 milionë euro, që paraqet një rritje për 21 përqind në krahasim me rezultatet financiare një vit më herët (2012: 12.6 milionë euro). Të ardhurat e Bankës Raiffeisen në Kosovë dominohen fuqishëm nga të ardhurat e krijuara nga kreditë dhe paradhëniet për klientët lokalë. Kjo do të thotë që të ardhurat krijohen kryesisht në territorin e Kosovës dhe nuk janë prekur nga kriza e vazhdueshme në disa nga vendet e BE-së. Të ardhurat nga shërbimet e tjera bankare janë rritur gjithashtu në vitin 2013 me 1.3 pikë përqindjeje.

Struktura e të ardhurave për vitin 2013 është paraqitur në skemën më poshtë.

Shpenzimet e përgjithshme dhe administrative (duke përfshirë amortizimin e pasurive fikse) në datën 31 dhjetor 2013 ishin 25 milionë euro (2012: 26.4 milionë euro). Koefficienti të ardhura/shpenzime ishte 54.6 përqind (2012: 58.3 përqind). Shpenzimet e personelit përfshijnë po ashtu edhe shpenzimet që lidhen me personelin, të tilla si trajnimi dhe zhvillimet tjera profesionale. Këto shpenzime vazhdojnë të jenë një pjesë e rëndësishme e shpenzimeve operative sepse Banka konsideron që personeli është shumë i rëndësishëm për zhvillimin e ardhshëm.



Numri i përgjithshëm i punonjësve në Bankën Raiffeisen në Kosovë deri me datën 31 dhjetor 2013 ishte 684 punonjës (2012: 675 punonjës).



Numri i degëve të Bankës Raiffeisen më 31 Dhjetor 2013 ishte 52, ndërsa numri i bankomatëve dhe pikave të shitjes ka vazhduar me trende rritje në treg duke i dërguar produktet dhe shërbimet bankare më afër qytetarëve të Kosovës. Kjo strategji me kanale të shumëllojshme të shpërndarjes ka mundësuar një shpërndarje të lehtë të produkteve dhe shërbimeve për klientët e bankës. Rrjeti i degëve dhe nëndegëve përbëhet nga 9 degë kryesore dhe 43 nëndegë.

Thesari

Tregu i parasë së Kosovës dhe kostoja e parave

Viti 2013 ishte i suksesshëm sa i përket mbledhjes dhe konsolidimit të depozitave. Banka Raiffeisen në Kosovë ka arritur të mbajë klientët e saj kryesorë të depozitave. Duke u bazuar në rritjen e besimit në sistemin financiar, veçanërisht brendin e Bankës Raiffeisen në Kosovë, likuiditeti i bankës ka mbetur në nivel të qëndrueshëm, duke ulur kështu kostot e financimit vit pas viti. Menaxhimi i kujdesshëm i pasurive dhe detyrimeve bëri të mundur që Banka të mbajë koston më të ulët të fondeve në treg në krahasim me konkurrencën, që nga ana tjetër mundësoi norma më të ulëta të kredive për produkte të caktuara. Në masë të madhe kursimet në shpenzimet e interesit janë arritur nëpërmjet modelimit sasior në menaxhimin e pasurive dhe detyrimeve. Banka përdor modelimin sasior për ta zbuluar sjelljen e klientëve, profilet e pandryshueshmërisë për pasuritë dhe detyrimet që nuk maturojnë, si për klientët e shitjes me pakicë ashtu edhe ata jo pakicë.

Vlera e pikëve bazë (VPB) në vitin 2013, ka rënë në më pak se 24,000 VPB.

Lakorja historikisht e ulët e euros ka mundësuar një lehtësim për bankat në Kosovë, duke i lejuar ato që të vazhdojnë të ofrojnë kredi për ekonominë e Kosovës. Megjithatë, kostot e likuiditetit të Kosovës mbeten të larta për shkak të riskut të vendit. Shpenzimet e likuiditetit janë të larta kryesisht për shkak të parametrave të riskut të shtetit të Kosovës, edhe pse likuiditeti i tregut është rritur ndjeshëm në gjysmën e dytë të vitit 2013. Deri më tani Kosovës nuk i është dhënë një vlerësim ndërkombëtar nga agjencitë e klasifikimit. Kjo e bën të vështirë detyrën e përcaktimit të çmimeve dhe si rrjedhojë vështirëson edhe investimet e huaja direkte në Kosovë.

Letrat me vlerë të qeverisë

Portfolio e bonove të bankave në letrat me vlerë të huaja dhe të qeverisë është rritur në 95 milionë euro, apo rreth 15 për qind të totalit të bilancit të gjendjes. Paralelisht, tregu i përgjithshëm për bonot e thesarit të Kosovës ka vazhduar të rritet. Duke pasur një rol të tregtuesit primar, Banka Raiffeisen në Kosovë dhe klientët e saj vazhduan të jenë një nga kontribuesit më të rëndësishëm në tregun e borxhit të Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Instrumentet financiare derivative

Portfolio e kundërkëmbimeve (SWAP) të normave të interesit të Bankës është një mjet i rëndësishëm për uljen e riskut për portfolion e saj afatgjatë. Rendimentet në treg kishin një efekt pozitiv në performancën e kësaj portfolioje në vitin 2013. Kundërkëmbimet e normave të interesit përdoren për të ulur rrezikun nga probabiliteti i rritjes së kostos së fondeve. Në muajt dhe vitet që vijnë ne besojmë se normat e tregut do të ndryshojnë nga më të ulëtat historikisht që janë ato aktuale. Duke pasur parasysh se industria bankare në Kosovë ka kryesisht kredi me normë fikse, instrumentet financiare derivative të kësaj natyre (kundërkëmbimet e normës së interesit) rrisin ndjeshmërinë e bilancit të gjendjes, i cili është i matur sepse risku i normës së interesit në këtë pikë të lakores së Euros është asimetrik.

Biznesi i shkëmbimit të valutës së huaj

Biznesi i këmbimit valutor ka krijuar më shumë se 1.4 milionë euro të ardhura në vitin 2013 që është pak më e ulët se në vitin 2012. Zyra përkatëse e Bankës Raiffeisen në Kosovë është zyra më profitabile në industrinë bankare në Kosovë. Përveç kësaj, biznesi i këmbimit valutor ka rritur qarkullimin në biznesin e të ardhurave nga komisioni për transferin e fondeve.

| Vitet | 2007 | 2008 | 2009 | 2010 | 2011 | 2012 | 2013 |
|---------------------------------------|-------|-------|-------|-------|-------|-------|-------|
| Të ardhurat në valutë të huaj në mijë | 1,052 | 1,073 | 1,392 | 1,326 | 1,766 | 1,543 | 1,407 |

Biznesi nga ndërmjetësimi

Në vitin 2013, Banka Raiffeisen në Kosovë ka shënuar përvjetorin e dytë të biznesit të ndërmjetësimit. Klientët e Bankës mund të tregtojnë në pothuajse të gjitha bursat në botë. Ky funksion u mundëson klientëve të blejnë dhe shesin letra me vlerë të tilla si bonot, obligacionet dhe aksionet në tregjet botërore.

Korporatat

Afarizmi bankar me korporata

Në vitin 2013, Banka Raiffeisen në Kosovë ka luajtur një rol shumë aktiv në sektorin bankar të korporatave duke punuar bashkë me klientët dhe duke ndërtuar marrëdhënie afatgjata. Është e rëndësishme që Banka të zhvillojë marrëdhënie me klientët me shumë sesa vetëm kredidhënia dhe mbledhja e depozitave, marrëdhënie nga e cila do të përfitojnë si klientët ashtu edhe Banka. Banka ju ofron klientëve këshilla financiare dhe të transaksioneve - një strategji që i ndihmoi Bankës të forcojë më tutje pozitën e saj në segmentin e korporatave si bankë udhëheqëse në vend. Përveç kësaj, ka pasur një fokus në ruajtjen e cilësisë së portfolios së kredive dhe rritjen e efikasitetit të procesimit të kredive.

Qëndrueshmëria e modelit të biznesit është pasqyruar nga një ecuri e qëndrueshme operative përmes cikleve të ndryshme ekonomike, që mundëson absorbimin e kostove të rrezikut më të lartë në kohën e pasigurisë ekonomike. Në vitin 2013, Banka Raiffeisen në Kosovë ka ofruar shërbime bankare për më shumë se 500 korporata duke ju mundësuar atyre zhvillimin e më tutjeshëm drejt arritjes së objektivave të tyre.

Pavarësisht nga kriza e Eurozonës e cila ka ndikuar në ekonominë e Kosovës dhe rënien e ekonomive në Evropën Juglindore, Banka Raiffeisen në Kosovë ka vazhduar të shënojë rritje të portfolios së kredive për korporata vit pas viti. Vëllimi i kredive u rrit nga 158 milionë euro në vitin 2012 në 177 milionë euro në vitin 2013, një rritje prej 11.6 për qind në krahasim me vitin e kaluar. Të ardhurat bruto arritën në 13.6 milionë euro që është një rritje prej 21.4 për qind nga viti në vit e ndjekur nga të ardhurat neto nga interesat që janë rritur në 11 milionë euro ose 22 për qind nga viti në vit. RoRAC (Kthimi në kapitalin e korrigjuar sipas riskut) ka mbetur i lartë në nivelin 134 për qind.

Nga ana tjetër e bilancit të gjendjes, pozicioni i likuiditetit ka mbetur i fortë pavarësisht disa rezultateve në detyrime dhe shpenzimet e interesit. Depozitat e korporatave kanë vazhduar të rriten dhe kanë arritur 113 milionë euro që është një rritje prej 44 për qind në krahasim me vitin e kaluar. Ne e konsiderojmë këtë një shenjë të mirë të besimit dhe besnikërisë së klientëve ndaj brendit të Bankës Raiffeisen.

Qëllimi i Bankës është që të vazhdojë të udhëheqë sektorin e korporatave edhe gjatë viteve të ardhshme duke ofruar produkte efikase dhe të përshtatura për klientët me anë të afarizmit sipas standardeve më të larta. Kjo do të thotë se Banka dëshiron të njihet jo vetëm për punën e saj, por edhe për vlerat që përfaqëson në çdo gjë që e bën.

Produktet për korporata

Në vitin 2013, Departamenti i Produkteve të Korporatave vazhdoi të bashkojë kërkesat e klientëve për financim shtesë me ofertën e produkteve dhe shërbimeve që përqendrohen në këshilla financiare, zgjidhje të përshtatura dhe mënyra të përshtatshme për kryerjen e shërbimeve bankare. Viti 2013 ishte një vit i suksesshëm për financimin e projekteve sepse janë zgjedhur dhe financuar zhvilluesit më të mirë lokalë të projekteve të pasurive të patundshme.

Gjithashtu duhet të theksohet se Banka ka vazhduar të përkrahë kompanitë me produktet e financimit të tregtisë. Këshilltarët e produkteve të financimit të tregtisë brenda Bankës kanë luajtur një rol vendimtar në dhënien e këshillave profesionale, përshtatjen e transaksioneve në përputhje me nevojat e klientit duke kontribuar kështu për të ulur ekspozimin e klientit ndaj rrezikut. Kjo është bërë e mundur duke pasur një përvojë të madhe në instrumente të tregtisë ndërkombëtare dhe duke pasur marrëdhënie të mira me një numër të madh të institucioneve financiare ndërkombëtare në të gjithë botën. Gjatë vitit 2013, përveç se ka vazhduar t'u ofrojë instrumente klientëve për kërkesat e tyre për transaksionet ndërkombëtare, Banka ka parë një interes në rritje të klientëve për produktet e financimit të tregtisë për transaksionet e brendshme.

Një zhvillim tjetër i madh gjatë vitit 2013 ka qenë në menaxhimin e parasë duke prezantuar një skemë të re tarifore që inkurajon transaksionet me e-banking. Qëllimet e skemës së re tarifore kanë qenë menaxhimi më i mirë i likuiditetit të klientëve, rritja e numrit të kanaleve elektronike për kryerjen e transaksioneve dhe shmangia e pagesave në para të gatshme.

Factoring është një produkt i ri në Kosovë i ofruar nga Banka Raiffeisen në Kosovë. Ka një rol potencialisht të madh në treg, duke ofruar likuiditet shtesë të bazuar në llogaritë e arkëtueshme. Në një mjedis sfidues ekonomik, strategjia është që të identifikohen klientët e përshtatshëm për këtë produkt dhe të ofrohet shërbimi i faktoring si përgjigje ndaj nevojave të tyre të biznesit.

Rritja e efikasitetit dhe eliminimi i aktiviteteve të panevojshme është një detyrë e përhershme e cila çon në shkurtimin e procesit të dhënies së kredive dhe plotësimin e pritjeve të klientëve për përfundimin e kredisë. Menaxhimi i marrëdhënies me klientin mundëson që punonjësit e shitjes ta arrijnë këtë me ndihmën e teknologjisë së fundit që mundëson menaxhimin e marrëdhënies me klientë.

Ndërmarrjet e vogla

Duke ditur se ndërmarrjet e vogla luajnë një rol shumë të rëndësishëm në zhvillimin e ekonomisë së Kosovës, Banka Raiffeisen në Kosovë ka vazhduar të ofrojë shërbime dhe përkrahje financiare për të cilën ata kanë nevojë që të zgjerojnë me sukses aktivitetet e tyre.

Në lidhje me kërkesat për financim të ndërmarrjeve të vogla, Banka Raiffeisen në Kosovë ka vazhduar të jetë një partner i besueshëm financiar dhe këshillues, duke përkrahur nevojat e reja dhe ekzistuese të klientëve përmes një niveli të lartë të shërbimit. Si rezultat i rritjes së ndërmarrjeve të vogla përmes përkrahjes së vazhdueshme financiare dhe këshillave, gjatë vitit 2013, një numër i konsiderueshëm i klientëve nga segmenti i ndërmarrjeve të vogla janë zhvendosur në segmentin më të madh të biznesit me korporata për t'u ofruar një gamë të plotë të zgjidhjeve financiare dhe përfitimeve që do t'u mundësojnë atyre ta zgjerojnë biznesin e tyre.

Një prioritet i lartë në vitin 2013 ishte forcimi i marrëdhënies me klientët ekzistues dhe zhvillimi i marrëdhënies afatgjata me klientët e rinj. Banka Raiffeisen në Kosovë është angazhuar për të ofruar përvojën e saj bankare, duke ofruar shërbime të tilla për klientë që dallohen në treg. Për ta lehtësuar këtë proces, ka prezantuar një strukturë e re për përkrahjen e rregullt të klientëve dhe kjo është dëshmuar se ka rezultate shumë të mira. Menaxherët me përvojë të gjatë dhe të suksesshme në marrëdhëniet me ndërmarrjet e vogla si dhe të specializuar në fushat e analizës financiare dhe këshillimit tani u shërbejnë klientëve në nivel rajonal.

Një prioritet tjetër në vitin 2013 ishte rritja e efikasitetit dhe cilësisë së shërbimit për klientët. Për ta arritur këtë qëllim, është prezantuar projekti më i madh ndonjëherë. Ai quhet "Lean për ndërmarrjet e vogla" dhe është i fokusuar tërësisht në përmbushjen e nevojave të klientit.

Për të mundësuar vendosjen e çmimeve për kreditë e Bankës në përputhje me riskun e biznesit të klientëve, Banka ka zhvilluar më tej modelin e saj të çmimit të bazuar në risk. Banka gjithashtu ka vazhduar të inkurajojë bizneset e vogla që të rrisin transparencën e tyre dhe të vazhdojnë biznesin e transaksioneve përmes Bankës Raiffeisen në Kosovë duke përdorur kanalet elektronike shërbimet bankare në internet dhe telefoni.

Gjatë vitit 2013, dhe si rezultat i të kuptuarit të detajuar dhe njohjes së marrëdhënies të klientëve me Bankën, është prezantuar produkti faktoring (blerja e borxheve) edhe për ndërmarrje të vogla duke bërë kështu që Banka Raiffeisen në Kosovë të jetë banka e parë në treg që ofron një produkt të tillë. Kjo do t'u mundësojë klientëve t'i marrin më shpejt pagesat për të arktueshmet e tyre.

Falë angazhimit të saj të vazhdueshëm ndaj ndërmarrjeve të vogla, Banka Raiffeisen në Kosovë ka qenë ndër bankat udhëheqëse në treg në vitin 2013 me rreth 37 për qind të pjesës së tregut.

Biznesi retail

Mikrobizneset

Banka Raiffeisen në Kosovë ka vazhduar përkrahjen e mikrobizneseve në mënyrë edhe më të theksuar gjatë vitit 2013, gjë e cila është reflektuar edhe në performancën e përgjithshme të këtij segmenti.

Fillimisht, është punuar në thjeshtësimin e mëtutjeshëm të procesit të kredidhënies, duke zvogëluar edhe në portfolion e kredive për këtë segment. Në të njëjtën kohë, zyrtarët bankarë kanë vizituar klientët në baza të rregulla dhe kanë identifikuar bashkarisht mënyrat më të mira të financimit të aktiviteteve të tyre.

Edhe në sferën e bujqësisë, Banka Raiffeisen ka rritur përkrahjen e saj dhe kjo ka ardhur si rezultat i marrëveshjes që Banka ka me USAID, marrëveshje kjo e cila ka ndikuar dukshëm në format e bashkëpunimit me klientë si dhe ka lehtësuar vendimmarrjen në lidhje me procesin e kredidhënies. Si rrjedhojë, një numër i konsiderueshëm i klientëve agro dhe mikrobiznese kanë pasur mundësi të përfitojnë kredi dhe forma të tjera të përkrahjes financiare. Për më tepër, bashkëpunimi me Ministrinë e Bujqësisë dhe USAID-in për zhvillimin, përkrahjen dhe financimin e Agro bizneseve ka vazhduar të jetë shumë i suksesshëm edhe gjatë vitit 2013.

Njëri ndër iniciativat e rëndësishme gjatë vitit 2013 ka qenë rritja e përdorimit të kanaleve alternative për kryerjen e shërbimeve të ndryshme bankare. Fillimisht ky projekt ka qenë mjaft sfidues, por pas bashkëpunimit të vazhdueshëm të zyrtarëve bankarë dhe klientëve, ofrimin të informacioneve dhe përkrahjes për përdorimin e këtyre shërbimeve, numri i klientëve në segmentin e mikrobizneseve që kanë filluar t'i shfrytëzojnë shërbimet elektronike ka shënuar rritje mjaft të kënaqshme.

Klientët individualë

Banka Raiffeisen në Kosovë ka vazhduar të ofrojë një shumëllojshmëri të gjerë të produkteve dhe shërbimeve bankare për të përmbushur kërkesat e klientëve të saj individualë dhe premium. Duke vazhduar ruajtjen e pozitës udhëheqëse në kredidhënie në treg gjatë vitit 2013, Banka u ka shërbyer më shumë se 234,000 klientëve aktivë individualë përmes 52 degëve në të gjithë vendin, duke përfshirë degë të veçanta Premium në qytetet kryesore të Kosovës.

Banka ka arritur të ruajë rritjen e saj të kujdesshme të kredidhënies në vitin 2013, por në të njëjtën kohë ka rritur në mënyrë të konsiderueshme disbursimin e kredive të reja. Fushatat kreative të kredidhënies kanë mundur një rritje të qëndrueshme në krahasim me tregun në çdo tremujor të vitit 2013. Banka gjithashtu ka vazhduar të jetë brendi i zgjedhur për shumë klientë të rinj të depozitave.

Për të zhvilluar më shumë personalin që ju shërbejnë klientëve në degë dhe nëndegë, Banka ka ofruar disa kurse trajnimi për shitje, shërbime dhe produkte.

Banka Raiffeisen në Kosovë ka vazhduar të sigurojë se klientët e saj Premium kanë mundësi për të diskutuar në detaje planet e tyre financiare dhe mundësitë e investimeve me menaxherin e tyre të dedikuar të marrëdhënies me klientë në një zonë të veçantë që është caktuar vetëm për klientët Premium. Gjatë vitit 2013, Banka ka prezantuar një program të ri të quajtur Premium Club (Klubi Premium). Duke qenë pjesë e Klubit Premium, klientët marrin zbritje dhe oferta të ndryshme promovuese në një gamë të gjerë të dyqaneve kur paguajnë me kredit kartelat e tyre Gold.

Menaxhimi dhe zhvillimi i produkteve

Mjedisi i biznesit po ndryshon çdo ditë dhe kjo vazhdimisht rrit qasjen proaktive të menaxhimit dhe zhvillimit të produkteve të Bankës. Në vitin 2013, përqendrimi ishte në përmirësimin e biznesit të debit dhe kredit kartelave, ofrimin e produkteve fleksibile të kredidhënies, rritjen e kanaleve ekzistuese alternative dhe futjen e produkteve të reja të sigurimit.

Gjatë kësaj periudhe, Banka Raiffeisen në Kosovë ka ndryshuar dizajnin e pakos së saj të llogarisë rrjedhëse duke shtuar më shumë përfitime dhe duke e bërë atë më tërheqëse për klientët.

Banka gjithashtu ka prezantuar produkte të reja të kartelave për pagesa me këste dhe kartelave të biznesit, ka shtuar shërbime shtesë si SMS dhe shërbimet bankare në internet, përmes së cilave tani ofrohet mundësia për të paguar tatimet dhe kontributet pensionale. Po ashtu, Banka ka prezantuar sigurimin jetësor për klientët premium. Me një qasje të personalizuar të marketingut Banka ka qenë në gjendje të rrisë kënaqësinë e klientëve me produktet dhe shërbimet e saj, si pjesë e qëllimit për të krijuar një marrëdhënie afatgjata me klientin.

Kanalet e distribuimit

Rrjeti i degëve

Banka Raiffeisen në Kosovë ka një rrjet të gjerë të degëve që u lejojnë klientëve të saj të kenë qasje të thjeshtë dhe të lehtë në produktet bankare. Viti 2013 u përqendrua kryesisht në forcimin e aftësive të personelit të degëve për të dhënë këshilla më komplekse financiare dhe zgjidhje për nevojat e klientëve. Përveç kësaj kohë e konsiderueshme është investuar në kujdesin ndaj klientëve.

Viti 2013 ishte një vit i konsolidimit dhe përmirësimeve në objektet e degëve dhe Banka ka modernizuar rrjetin e degëve të saj duke ri-modeluar dy degë në Gjakovë dhe Gjilan. Banka gjithashtu ka hapur nëndegën në Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës dhe dy pika terminali në Jarijë dhe Bërnjak të cilat konfirmojnë angazhimin e Bankës drejt ofrimit të një niveli të lartë të shërbimeve cilësore.

Kanalet tjera të distribuimit

Qendra telefonike e Bankës Raiffeisen ka vazhduar të ofrojë shërbime 24 orë 7 ditë në javë, shërbime këto të vlerësuara shumë mirë në treg në bazë të hulumtimeve që janë kryer nga ana e Bankës. Ndërsa aktivitetet afariste me Pikat e Shitjes (POS) janë përqendruar kryesisht në forcimin e marrëdhënieve me dyqanet tregtare, njëkohësisht duke bërë përmirësime të reja teknike për përdorimin e terminaleve të pikave të shitjes. Për herë të parë, Banka ka instaluar pikën e shitjes që mundëson pagesa me këste për të bërë blerjet më të volitshme për klientët tanë.

Shërbimi për klientë

Nevojat e klientit ndryshojnë vazhdimisht, dhe Banka synon të tejkalojë pritjet e tyre për të ripërcaktuar dhe prezantuar përvoja të reja të shërbimeve të cilësisë më të lartë. Gjatë vitit 2013, angazhimi i Bankës ka qenë të krijojë dhe të mbajë marrëdhënie të mira me klientët e saj duke përmirësuar mënyrën se si i shërben çdo klienti në çdo ndërveprim të klientit me Bankën.

Një nga arritjet ishte të kuptohet qartë zëri i klientëve që ndihmoi të identifikohen proceset kryesore dhe ndërveprimet që ndikojnë tek klienti në mënyrë që ai të jetë i kënaqur me shërbimet e ofruara. Trajtimi i reagimeve të klientëve në mënyrë të drejtë dhe profesionale ishte thelbësore për mbajtjen e biznesit konkurrues dhe klientëve të kënaqur.

Të gjitha të gjeturat nga burime të ndryshme të hulumtimit janë përkthyer në veprime për përmirësim të mëtejshëm për të krijuar marrëdhënie të mirë me klientët. Përveç kësaj, janë identifikuar proceset kryesore me ndikimin më të madh në përvojën e klientit dhe janë marrë një sërë iniciativash për të përmirësuar secilën përvojë të klientit brenda Bankës.

Në vitet e ardhshme do të vazhdojmë të përmirësojmë shërbimet për klientë për të arritur qëllimin e Bankës që të jetë Banka më e mirë në treg.

Menaxhimi i kredive dhe riskut

Menaxhimi i riskut ka vazhduar të forcojë përgjegjësitë dhe funksionet e veta gjatë vitit 2013. Struktura e departamentit është forcuar duke krijuar një funksion të ri kontrollues të rrezikut që do të mbulojë funksione të tilla si menaxhimi i riskut të bilancit të gjendjes, riskut të integruar, riskut operativ dhe riskut të likuiditetit.


Theks i veçantë i është dhënë standardeve të larta të riskut operacional dhe Banka Raiffeisen në Kosovë do të jetë në gjendje për të forcuar më tej matjen, monitorimin dhe aktivitetet parandaluese të riskut operacional, duke përfshirë menaxhimin e mashtrimit. Ekipi për menaxhimin e kolateralit është forcuar edhe për të mundësuar aprovimet më të sakta dhe më profesionale.

Sistemi i vlerësimit të klientëve të Bankës është përmirësuar gjatë vitit dhe do të mundësojë që Banka të kuptojë edhe më mirë profilet e riskut të klientit për t'i mundësuar Bankës të ruajë cilësinë e shkëlqyer të portfolios kreditorë.

Operacionet

Pagesat

Gjatë vitit 2013, Banka Raiffeisen në Kosovë ka rritur numrin total të pagesave në 810,709, një rritje prej 19 për qind në krahasim me vitin 2012, ndërsa shuma totale e pagesave ishte 4,596 milionë e rritur për 5 për qind në krahasim me vitin 2012.





Shfrytëzimi i rritur i shërbimeve elektronike të Bankës ka pasur ndikim në numrin e transaksioneve dhe përdoruesve. Numri i përdoruesve është rritur për më shumë se 100 për qind në krahasim me vitin 2012.

Numri i përgjithshëm i transaksioneve me E-banking është rritur për 26 për qind në krahasim me vitin 2012.

Financimi tregtar

Banka Raiffeisen në Kosovë përkrah dhe financon një vëllim të rëndësishëm të tregtisë vendore dhe ndërkombëtare, duke ofruar produkte të ndryshme financiare tregtare.

Siç paraqitet në diagramin e mëposhtëm, gjatë vitit 2013 vëllimi i produkteve të financimit tregtar ishte € 65 milionë euro.



Gjithashtu, vlera e produkteve financiare tregtare në qarkullim deri në fund të vitit 2013 kapte shifrën prej 47 milionë euro.

Procesimi i pagave

Procesimi i pagave është një nga produktet që Banka i ofron për klientët e biznesit dhe përfshin procesimin e listave të pagave dhe barazimet. Numri i përgjithshëm i pagave të procesuara në vitin 2013 ishte 4,430 me një qarkullim total prej 226 milionë euro. Krahasuar me vitin 2012, ky shërbim ka arritur një rritje prej 4.27 për qind.

Llogaritë e inkasimit

Llogaritë e inkasimit janë shërbime që Banka i ofron për klientët e biznesit të cilët kanë llogari në Bankën Raiffeisen në Kosovë. Numri i përgjithshëm i pagesave të procesuara në vitin 2013 arriti në 244,836, me një qarkullim total prej 156 milionë euro. Krahasuar me vitin 2012, numri i pagesave tregoi një rritje prej 3.37 për qind.

Teknologjia informative dhe e kompjuterëve

Banka Raiffeisen në Kosovë ka vazhduar të investojë në teknologjinë informative dhe kompjuterike (TIK). Departamenti i TIK menaxhon dhe kujdeset për një numër të madh të programeve dhe sistemeve të sofistikuar dhe komplekse. Si rezultat i nivelit të lartë të profesionalizmit, në vitin 2013, departamenti i TIK me sukses ka vërtetuar certifikimin 'ISO/IEC 20000-1:2011' të fituar dy vjet më parë, kur Banka Raiffeisen në Kosovë u bë banka e parë në Evropën Juglindore që ka marrë njohje të tillë ndërkombëtare.

Çfarë e bën Bankën Raiffeisen në Kosovë unike në tregun e Kosovës, por edhe në rajon është matura në Menaxhimin e vazhdimësisë së biznesit (MVB) dhe Qendra efikase për rimëkëmbje nga katastrofat (DRC). Gjatë vitit 2013, ka pasur një testim për MVB dhe DRC për të verifikuar dhe vërtetuar planet që sigurojnë vazhdimësinë e aktiviteteve të Bankës edhe në raste ekstreme të cilat nuk do të ndikojnë në klientët ose shërbimet e Bankës Raiffeisen. Ky simulim tregon se Banka Raiffeisen në Kosovë mund të mbijetojë pas një situatë ku Qendra kryesore e të dhënave (dhoma e serverëve) shkatërrohet plotësisht, ndërsa nuk ka asnjë ndikim negativ tek klientët. Kjo e bën Bankën Raiffeisen në Kosovë një bankë të nivelit më të lartë botëror për TI dhe shërbimet e saj.

Gjatë vitit 2013, TI e Bankës Raiffeisen në Kosovë është përfshirë shumë në përmirësimin e produkteve të kartelave, kanaleve elektronike dhe proceseve të brendshme të automatizimit për të mundësuar një përvojë më të mirë të klientëve.

Departamenti i TIK është i vendosur të vazhdojë suksesin e vet dhe t'i mundësojë Bankës të kërkojë mundësi të reja të biznesit duke ofruar zgjidhje dhe shërbime ekonomike, të besueshme, të sigurt dhe të mbrojtura për klientët e saj.

Trajnimi dhe menaxhimi i personelit

Të qenit punëdhënësi i më të mirë në Kosovë është misioni i Bankës Raiffeisen në Kosovë e cila tregon një angazhim të madh ndaj punëtorëve të Bankës. Transferet e brendshme dhe ngritjet në pozitë vazhdojnë të shërbejnë si një nga mjetet e zhvillimit të kapitalit të brendshëm njerëzor të bankës. Numri i përgjithshëm i transfereve të brendshme dhe ngritjeve në pozitë gjatë vitit 2013 ishte 75 që është një rritje prej 11 për qind nga viti 2012. Numri total i punëtorëve që iu bashkua ekipit të Bankës gjatë vitit 2013 ishte 58.

Banka Raiffeisen në Kosovë vazhdon të përkrahë zhvillimin e potencialit të ri të Kosovës dhe u ndihmon punëkërkuarëve të përmirësojnë mundësitë e tyre të punësimit. Një nga projektet të cilin Banka e ka përkrahur për disa vite është "Atomi" që është zbatuar nga Qendra Encompass. Si pjesë e trajnimit të tyre, janë mbajtur tema të veçanta për pjesëmarrësit me një nivel të lartë të Inteligjencës (IQ), nga punëtorët e Banka Raiffeisen.

Zhvillimi i kapaciteteve njerëzore të brendshme dhe të jashtme vazhdon të jetë një nga qëllimet kryesore të Bankës. Me këtë në mendje, Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe i Trajnimit ka menaxhuar dhe marrë pjesë në aktivitete të ndryshme që kanë luajtur një rol të rëndësishëm në zhvillimin e studentëve me arritjet më të larta në Kosovë. Banka ka vazhduar programin e saj të praktikës me studentët më të mirë të disa universiteteve në Kosovë dhe 75 studentë janë angazhuar në një program praktike në vitin 2013. Marrja e 627 aplikacioneve nga studentët tregon se Banka Raiffeisen mbetet një nga institucionet e preferuara të studentëve të universitetit për hapat e tyre të para të karrierës.

Banka Raiffeisen në Kosovë është e angazhuar për të siguruar që punëtorët e saj zhvillojnë njohuritë dhe aftësitë e tyre duke u ofruar atyre një shumëllojshmëri të mundësive të të mësuarit dhe zhvillimit përmes aftësisimit në vendin e punës, trajnimit në klasë të brendshme dhe të jashtëm, eLearning (të mësuarit me mjete elektronike), detyra të mësimi dhe përfshirjen në projekte sfiduese vendore dhe ndërkombëtare. Këto projekte kanë pasur si rezultat përmirësimin e njohurive në fushën e produkteve dhe shërbimeve bankare. Në këtë mënyrë, Banka fiton përparësi konkurruese në treg duke ofruar një shërbim më profesional dhe efikas për klientët e saj.

Gjatë vitit 2013, 64 për qind e punonjësve kanë marrë pjesë në programe të ndryshme trajnuese dhe pothuajse 100 për qind kanë marrë pjesë në seminare. Shifrat tregojnë një nivel të shkëlqyer të arritjeve sipas standardeve evropiane, me një mesatare prej 2.3 ditë trajnimi për punëtor në vitin 2013. Duke zgjeruar gamën e ofertave të trajnimit, duke ruajtur numrin e trajnerëve të brendshëm, dhe vazhdimisht duke përmirësuar cilësinë e ofrimit të trajnimit, Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Trajnimit ka arritur të organizojë një numër të madh të kurseve për punëtorët e vet. Gjatë vitit 2013, numri i ditëve të trajnimit ka qenë 1,815 ditë, dhe janë zhvilluar 189 seanca brenda vitit.

Banka Raiffeisen në Kosovë bashkëpunon me ofrues të ndryshëm të trajnimeve brenda dhe jashtë Kosovës për programe të veçanta të trajnimit. Identifikimi i nevojave për trajnim bëhet vazhdimisht për të pasur programe të përshtatura që përmbushin nevojat e punëtorëve. Ka edhe plane individuale të zhvillimit për një numër të punonjësve, të cilat përqendrohen në mënyrë specifike në aftësitë e një individi dhe rrisin mundësinë e zhvillimit personal.

E-Learning, ka qenë gjithashtu një mënyrë shumë aktive e të mësuarit gjatë vitit 2013. Në vitin e tretë të ekzistimit ka pasur një ngritje mbresëlënëse të interesimit dhe përkrahjes nga punonjësit e Bankës për të ndjekur kurse të brendshme. Gjatë vitit 2013, kemi pasur mbi 3000 punëtorë të regjistruar në kurset e krijuara brenda Bankës Raiffeisen në Kosovë dhe kurse të Raiffeisen Bank International. Përmes e-Learning dhe të mësuarit të përzier, Banka tashmë është bërë më efikase dhe ekonomike në ofrimin e programeve për të gjithë punëtorët në një periudhë shumë të shkurtër kohe. “Ebinaret”, seminarët përmes telefonit dhe testimi elektronik i njohurive ishin metoda të tjera të reja të eLearning të përdorura në vitin 2013.

Në vitin 2013, një iniciativë e brendshme e zhvillimit e quajtur “Akademia Diamond” vazhdoi përveç programit të vazhdueshëm Akademia e Leadershipit. Këto programe të brendshme kanë për qëllim të zhvillojnë njohuritë dhe ekspertizën e punonjësve më të talentuar dhe menaxherëve të bankës përmes një kombinimi të mirë të metodave praktike, alternative dhe akademike të të mësuarit.

Përveç aktiviteteve të përmendura tashmë, Banka Raiffeisen në Kosovë ka vazhduar të sponsorizojë kurse të veçanta në një gamë të gjerë temash nga aftësitë teknike deri te aftësitë “e buta” (ndërpersonale) si pjesë e përkrahjes së saj specifike për ngritjen e kapaciteteve. Mësimi gjatë gjithë jetës mbetet një nga porositi kryesore në Bankë.

Pasqyrat Financiare

Raporti i auditorit të pavarur dhe pasqyrat financiare individuale për vitin që përfundoi me 31 dhjetor 2013, të përgatitura në pajtim me standardet ndërkombëtare të raportimit financiar.

Shënim: Raporti i auditorit të pavarur dhe pasqyrat financiare individuale janë përgatitur në gjuhën angleze.
Prandaj, versioni në gjuhën angleze e mbizotëron versionin e përkthyer në gjuhën shqipe.

| | |
|--|-----------|
| Deklarata mbi përgjegjësinë e menaxhmentit | 28 |
| Raporti i auditorit të pavarur | 29 |
| Pasqyra individuale e pozitës financiare | 30 |
| Pasqyra individuale e fitimit dhe humbjes dhe të ardhurave tjera gjithëpërfshirëse | 31 |
| Pasqyra individuale e ndryshimeve në ekuitetit | 32 |
| Pasqyra individuale e rrjedhës së parasë | 33 |
| Shënimet për pasqyrat individuale financiare | 34-65 |

Deklarata mbi përgjegjësitë e menaxhmentit

Për aksionarët dhe Bordin e Drejtorëve të Bankës Raiffeisen në Kosovë J.S.C.

Ne më datën 31 dhjetor 2013 i kemi përgatitur pasqyrat financiare për vitin që e lamë pas, të cilat paraqesin në mënyrë të saktë të gjitha aspektet materiale të pozitës financiare të Bankës Raiffeisen në Kosovë J.S.C. (në tekstin e mëtejme 'Banka') më 31 dhjetor 2013 si dhe rezultatet e veprimtarisë së saj dhe rrjedhën e parasë për vitin kaluar. Menaxhmenti është përgjegjës për të siguruar se Banka i mbanë llogaritë në pajtueshmëri me rregulloret bankare të Kosovës, të cilat mund të ndryshohen për të pasqyruar me saktësi të arsyeshme gjendjen financiare të Bankës dhe rezultatet e veprimtarisë së saj dhe rrjedhën e parasë sipas Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar, përfshirë edhe Standardet dhe Interpretimet Ndërkombëtare të Kontabilitetit, të cilat janë nxjerrë nga Bordi Ndërkombëtar i Standardeve të Kontabilitetit (IASB) dhe Komiteti Ndërkombëtar për Interpretime të Raportimit Financiar (IFRIC) i IASB-së, të cilat janë relevante për veprimtarinë e saj dhe të cilat ishin në fuqi për periudhën të cilën e mbulojnë të dhënat. Menaxhmenti ka edhe përgjegjësi të përgjithshme për t'i ndërmarrë të gjithë hapat e arsyeshëm në dispozicionin e vet për të ruajtur asetet e Bankës dhe për të zbuluar dhe parandaluar manipulimet dhe parregullsitë tjera.

Menaxhmenti konsideron se gjatë përgatitjes së pasqyrave financiare Banka i ka shfrytëzuar politikat adekuata kontabile, të cilat janë zbatuar në mënyrë konsistente dhe janë mbështetur me gjykime dhe vlerësime të arsyeshme dhe të kujdesshme, dhe se gjatë kësaj janë përcjellë Standardet përkatëse Ndërkombëtare të Raportimit Financiar.

Rrjedhimisht, pasqyrat financiare konsiderohen të miratuara nga Bordi Menaxhues.

Prishtinë, Kosovë
20 mars 2014


Bordi Menaxhues i Bankës Raiffeisen në Kosovë



Robert Wright
Kryesues i Bordit Menaxhues



Shukri Mustafa
Anëtar i Bordit Menaxhues



Iliriana Toçi
Anëtare e Bordit Menaxhues



Johannes Riepl
Anëtar i Bordit Menaxhues



KPMG Albania Sh.p.k, Dega
Kosovë
14, Rruga Sulejman Vokshi
Prishtinë, Kosovë

Tel: + 381 (38) 246771
Fax: + 381 (38) 246772
Mail: al-kosovo@kpmg.com
www.kpmg.al

Raport i auditorit të pavarur

Për aksionarët dhe Bordin e Drejtorëve të Raiffeisen Bank Kosova Sh.A.

Ne kemi audituar pasqyrat shoqëruese financiare të Raiffeisen Bank Kosovës Sh.A. ("Banka"), të cilat përfshijnë pasqyrën e gjendjes financiare më 31 dhjetor 2013, pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve dhe të ardhurave të tjera përmbledhëse, ndryshimet në ekuitet dhe likuiditet për vitin që ka përfunduar, si dhe shënimet, të cilat përmbajnë një përmbledhje të politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe informata të tjera sqaruese.

Përgjegjësia e menaxherit për pasqyrat financiare

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të këtyre pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar, dhe për kontrolle të brendshme, të cilat menaxhmenti përcakton se janë të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare pa gabime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose të gabimit.

Përgjegjësia e auditorit

Përgjegjësia jonë është të shprehim një opinion mbi këto pasqyra financiare bazuar në auditimin tonë. Ne kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto standarde kërkojnë që ne të zbatojmë kërkesat etike dhe të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të fituar siguri të arsyeshme se pasqyrat financiare janë pa gabime materiale.

Auditimi përfshin kryerjen e procedurave për të marrë evidencë auditimi për shumat dhe raportimet në pasqyrat financiare. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi, duke përfshirë vlerësimin e rrezikut të gabimeve materiale të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Në bërjen e këtyre vlerësimeve të rrezikut, ne konsiderojmë kontrollin e brendshëm në lidhje me përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare nga ana e subjektit, në mënyrë që të dizajnohen procedurat e auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efikasitetin e kontrollit të brendshëm të subjektit. Një auditim përfshin gjithashtu vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, gjithashtu dhe vlerësimin e prezantimit të përgjithshëm të pasqyrave financiare.

Ne besojmë se evidenca e auditimit që ne kemi nxjerrë është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar bazat për opinionin tonë të auditimit.

Opinionit

Sipas mendimit tonë, pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Bankës më 31 dhjetor 2013, dhe performancën e saj financiare dhe likuiditetin për vitin e përfunduar në pajtim me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar.

Çështje të tjera

Pasqyrat financiare të Bankës për gjendjen dhe vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2012 janë audituar nga një auditor tjetër, raporti i të cilit i datës 20 mars 2013 shprehu një opinion të pakualifikuar për ato pasqyra financiare.

Prishtinë,
20 mars, 2014


Pasqyra individuale e gjendjes financiare

| (vlerat në € 000) | Notes | 31 dhjetor 2013 | 31 dhjetor 2012 |
|--|-------|--------------------|--------------------|
| Pasuritë | | | |
| Paraja dhe ekuivalentët e parasë dhe rezerva e detyrueshme | 6 | 77,474 | 86,218 |
| Kreditë dhe paradhëniet për bankat | 7 | 63,194 | 46,103 |
| Kreditë dhe paradhëniet për klientët | 8 | 432,251 | 401,066 |
| Kreditë tjera | 9 | 19,322 | 20,873 |
| Investimet në letra me vlerë | 10 | 95,920 | 64,102 |
| Investimet në variës | 11 | 336 | 333 |
| Pasuri tjera | 12 | 3,124 | 2,188 |
| Përmirësimi i pronës me qira, pajisjet dhe pasuritë e paprekshme | 13 | 6,514 | 7,613 |
| Gjithsej pasuritë | | 698,135 | 628,496 |
| Detyrimet | | | |
| Depozitat nga klientët | 14 | 557,667 | 513,869 |
| Depozitat dhe huamarrjet nga bankat | 15 | 4,542 | 4,213 |
| Detyrimet tjera | 16 | 6,843 | 9,530 |
| Detyrimi i tatimit të shtyrë | 23 | 2,832 | 1,648 |
| Kredi e varur | 17 | 19,283 | - |
| Gjithsej detyrimet | | 591,167 | 529,260 |
| Ekuiteti i aksionarëve | | | |
| Kapitali aksionar | 18 | 58,000 | 58,000 |
| Fitimet e mbajtura | | 48,968 | 41,236 |
| Rezerva e vlerës së drejtë | | - | - |
| Gjithsej ekuiteti i aksionarëve | | 106,968 | 99,236 |
| Gjithsej detyrimet dhe ekuiteti i aksionarëve | | 698,135 | 628,496 |

E aprovuar që të lëshohet në emër të Menaxhmentit të Bankës Raiffeisen në Kosovë Sh.A. dhe e nënshkruar në emër të tyre më 20 mars 2014.



Shukri Mustafa
Chief Operations Officer
Management Board Member



Robert Wright
Chief Executive Officer
Management Board Member

Pasqyra individuale e gjendjes financiare lexohet së bashku me shënimet e saj dhe formon pjesë të pasqyrave individuale financiare të paraqitura në faqet 34 deri 65.

Pasqyra individuale e fitimit dhe humbjes dhe të ardhurave gjithëpërfshirëse

| (Vlerat në € 000) | Shënimet | December 31, 2013 | December 31, 2012 |
|---|----------|----------------------|----------------------|
| Interest income | 19 | 46,800 | 47,606 |
| Interest expense | 19 | (9,100) | (10,266) |
| Neto të ardhurat nga interesi | | 37,700 | 37,340 |
| Provizioni për dëmtimin e kredisë | 8 | (5,456) | (5,295) |
| Kthimi nga kreditë e shlyera | | 1,183 | 1,016 |
| Provizioni për humbjet nga zotimet dhe detyrimet kontigjente | | 102 | (221) |
| Neto të ardhurat nga interesi pas provizioneve | | 33,529 | 32,840 |
| Të ardhurat nga tarifat dhe komisionet | 20 | 11,112 | 10,881 |
| Shpenzimet për tarifa dhe komisione | 20 | (3,153) | (3,084) |
| Neto të ardhurat nga tregtimi | | 93 | 135 |
| Neto vlerësimi i instrumenteve financiare që mbahen për tregtim | | 799 | (570) |
| Neto vlerësimi i investimeve në ekuitetit | | - | 500 |
| Të ardhura tjera operative | | 134 | 82 |
| Të ardhura operative | | 42,514 | 40,784 |
| Shpenzimet e personelit | 21 | (10,764) | (10,685) |
| Shpenzime tjera operative | 22 | (14,758) | (15,929) |
| Fitimi para tatimit në të ardhura | | 16,992 | 14,170 |
| Shpenzimet e tatimit në të ardhura | 23 | (1,760) | (1,549) |
| Fitimi i vitit | | 15,232 | 12,621 |
| Të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse | | | |
| Rezultati i vlerësimit të instrumenteve financiare në dispozicion për shitje të regjistruara në ekuitet | | - | (442) |
| Gjithsej të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse të vitit | | 15,232 | 12,179 |

Pasqyra individuale e fitimit dhe humbjes dhe të ardhurave tjera gjithëpërfshirëse lexohet së bashku me shënimet e saj dhe formon pjesë të pasqyrave individuale financiare të paraqitura në faqet 34 deri 65.

Pasqyra individuale e ndryshimit në kapital

| (vlerat në € 000) | Kapitali aksionar | Fitimet e mbajtura | Rezerva e vlerës së drejtë | Gjithsej ekuiteti i aksionarëve |
|--|-------------------|--------------------|----------------------------|---------------------------------|
| Gjendja më 1 janar 2012 | 58,000 | 40,615 | 442 | 99,057 |
| Dividenda e shpërndarë | | (12,000) | | (12,000) |
| Fitimi i vitit | - | 12,621 | - | 12,621 |
| Neto ndryshimi i vlerës së drejtë të PFV | - | - | (442) | (442) |
| Gjendja më 31 dhjetor 2012 | 58,000 | 41,236 | - | 99,236 |
| Dividenda e shpërndarë | | (7,500) | | (7,500) |
| Fitimi i vitit | - | 15,232 | - | 15,232 |
| Gjendja më 31 dhjetor 2013 | 58,000 | 48,968 | - | 106,968 |

Pasqyra individuale e ndryshimeve të ekuitetit lexohet së bashku me shënimet e saj dhe formon pjesë të pasqyrave individuale financiare të paraqitura në faqet 34 deri 65.

Pasqyra individuale e rrjedhjes së parasë

| (vlerat në € 000) | Shënimet | 31 dhjetor 2013 | 31 dhjetor 2012 |
|---|----------|--------------------|--------------------|
| Rrjedhat e parasë nga aktivitetet operative | | | |
| Interesi i pranuar në kredi | | 45,713 | 46,147 |
| Interesi i pranuar në plasime | | 18 | 94 |
| Interesi i pranuar nga bonot qeveritare | | (1,276) | 1,665 |
| Interesi i paguar | | (7,882) | (10,978) |
| Tarifat dhe komisionet e pranuar | | 11,178 | 10,895 |
| Tarifat dhe komisionet e paguara | | (3,153) | (3,084) |
| Neto vlerësimi i investimeve në ekuitetit | | - | 500 |
| Të ardhura tjera të pranuar | | 138 | 1,106 |
| Shpenzimet e personelit të paguara | | (10,992) | (10,452) |
| Shpenzime tjera operative të paguara | | (11,972) | (11,511) |
| Tatimi në të ardhura i paguar | | (250) | (1,295) |
| Rrjedha e parasë nga aktivitetet operative para ndryshimeve në pasuritë dhe detyrimet operative | | 21,522 | 23,087 |
| Ndryshimet në pasuritë dhe detyrimet operative | | | |
| Neto (zvogëlimi) / rritja e rezervës së detyrueshme të likuiditetit | | 734 | 5,764 |
| Neto zvogëlimi i kredive dhe paradhënies bankave | | (17,091) | 39,804 |
| Neto rritja e kredive dhe paradhënies klientëve | | (33,590) | 5,978 |
| Neto rritja e bonove qeveritare | | (29,502) | (1,950) |
| Neto (zvogëlimi) / rritja në pasuritë tjera | | (1,261) | (5) |
| Neto rritja e llogarive të klientëve | | 43,981 | (43,465) |
| Net rritja / (zvogëlimi) i depozitave nga bankat | | 17 | (465) |
| Neto rritja (zvogëlimi) i detyrimeve tjera | | (2,693) | (3,289) |
| Neto rrjedha e parasë (e shfrytëzuar)/nga aktivitetet operative | | (17,883) | 25,459 |
| Rrjedha e parasë nga aktivitetet investuese | | | |
| Pagesat për përmirësimin e pronës me ajra, pajisjeve dhe pasurive të paprekshme | | (2,112) | (2,981) |
| Neto paraja e shfrytëzuar në aktivitete investuese | | (2,112) | (2,981) |
| Rrjedha e parasë nga aktivitetet financuese | | | |
| Kthimi i huamarrjeve | | 382 | (8,891) |
| Të ardhurat nga kredia e varur | | 19,000 | - |
| Dividendat e shpërndara | | (7,500) | (12,000) |
| Neto rrjedha e parasë nga/(e shfrytëzuar në) aktivitetet financuese | | 11,882 | (20,891) |
| Efekt i ndryshimit të normës së shkëmbimit valutor | | 104 | 30 |
| Neto zvogëlimi i parasë dhe ekuivalentëve të parave | | (8,009) | 1,617 |
| Paraja dhe ekuivalentët e parave në fillim të vitit | 6 | 35,354 | 33,737 |
| Paraja dhe ekuivalentët e parave më 31 dhjetor (pa përfshirë rezervën e detyrueshme të likuiditetit) | 6 | 27,345 | 35,354 |

Pasqyra individuale e rrjedhës së parasë lexohet së bashku me shënimet e saj dhe formon pjesë të pasqyrave individuale financiare të paraqitura në faqet 34 deri 65.

Shënimet për pasqyrat financiare individuale për vitin që përfundoi më 31 dhjetor 2013

1. Njësia raportuese

Raiffeisen SEE Region Holding GmbH është aksionari që ka në pronësi 100% të Bankës Raiffeisen në Kosovë Sh.A. Raiffeisen SEE Region Holding GmbH është 100% vartës indirekt i Raiffeisen Bank International AG.

Në datën e themelimit të Bankës dhe deri në shkurt të vitit 2003, Banka është quajtur "Banka Amerikane e Kosovës". Gjatë shkurtit 2003 aksionarët e Bankës vendosën ta ndryshojnë emrin e Bankës në Bankës Raiffeisen në Kosovë Sh.A. Ndryshimi i emrit është aprovuar nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës ("BQK", e njohur më parë si Autoriteti Bankar dhe i Pagesave të Kosovës - BPK) më 28 prill 2003.

Banka operon sipas licencës bankare të lëshuar nga BQK më 8 nëntor 2001. Aktivitetet kryesore afariste të Bankës janë aktivitete komerciale dhe bankare me pakicë brenda Kosovës.

Më 31 dhjetor 2013, Banka ka 9 degë dhe 43 nëndegë brenda Kosovës (31 dhjetor 2012: 9 degë dhe 41 nëndegë). Zyra e regjistruar e Bankës është e vendosur në këtë adresë: Rruga UÇK nr. 51, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës.

2. Baza e përgatitjes

2.1. Deklarata e pajtueshmërisë

Pasqyrat financiare individuale janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar ("SNRF") dhe interpretimet e tyre të miratuara nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (BSNK).

2.2. Baza e përgatitjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur mbi bazën e kostos historike përveç zërave materialë në vijim:

| Zërat | Baza e matjes |
|---|----------------|
| Pasuritë financiare në dispozicion për shitje | Vlera e drejtë |
| Instrumentet financiare derivative | Vlera e drejtë |

2.3. Valuta funksionale edhe e prezantimit

Valuta funksionale e Bankës e përdorur në përgatitjen e pasqyrave financiare është EUR ashtu siç është valuta e mjedisit ekonomik primar në të cilin punon Banka dhe pasqyron substancën ekonomike të ngjarjeve themelore ("valuta funksionale"). Të gjitha shumat janë rrumbullakësuar në mijëshen më të afërt, përveç kur specifikohet ndryshe.

2.4. Përdorimi i gjykimeve dhe vlerësimeve

Në përgatitjen e këtyre pasqyrave financiare individuale, menaxhmenti ka bërë gjykime, vlerësime dhe supozime të cilat ndikojnë në zbatimin e politikave kontabël të Bankës dhe shumat e raportuara të pasurive, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë nga këto vlerësime.

Vlerësimet dhe supozimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve njihen në mënyrë prospektive.

Informacionet mbi fushat e rëndësishme të vlerësimit të pasigurive dhe gjykimeve kritike për zbatimin e politikave kontabël që kanë efektin më të konsiderueshëm në shumat e paraqitura në pasqyrat financiare janë përshkruar në shënimin 3.17.

3. Politikat kryesore kontabël

Politikat kontabël të mëposhtme janë zbatuar në vazhdimësi në të gjitha periudhat e prezantuara në këto pasqyra financiare individuale.

3.1. Vartësit dhe konsolidimi

Vartësit janë njësi ekonomike të kontrolluara nga Banka. Kontrolli ekziston kur Banka është e ekspozuar, ose ka të drejta, ndaj kthimit variabil nga përfshirja e saj me pranuesin e investimit (vartësin) dhe ka aftësinë të ndikojë në atë kthim përmes pushtetit të vet mbi pranuesin e investimit. Këto pasqyra financiare paraqesin rezultatin dhe gjendjen financiare vetëm të Bankës dhe nuk përfshijnë ato të vartësve të saj, siç është dhënë në detaje në shënimin 11.

Kompania amë nuk ka nevojë të prezantojë pasqyra financiare të konsoliduara, nëse vetë kompania amë është në vetvete vartës tërësisht në pronësi të dikujt dhe kompania amë përfundimtare ose e ndërmjetme e kompanisë amë përgatit pasqyra financiare të konsoliduara në dispozicion për përdorim publik që janë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar. Banka përgatit pasqyra financiare të veçanta në përputhje me SNRF. Interesat në vartës janë të llogaritura në bazë të kostos në pasqyrat financiare të veçanta.

3.2. Transaksionet në valuta të huaja

Transaksionet në valutë të huaj regjistrohen me kursin në ditën e transaksionit. Pasuritë dhe detyrimet monetare në valutë të huaj konvertohen me kursin e këmbimit në datën e raportimit.

Fitimet dhe humbjet nga shkëmbimi valutor si rezultat i pagesës së transaksioneve të tilla dhe nga konvertimi në kursin e këmbimit në fund të vitit të pasurive dhe detyrimeve monetare në valutë të huaj paraqiten në fitim dhe humbje.

Normat zyrtare të këmbimit spot për valutat kryesore të përdorura në konvertimin e zërave në valutë të huaj në datën e raportimit janë si më poshtë (në EUR):

| Krahasuar me EUR | 31 dhjetor 2013 | 31 dhjetor 2012 |
|------------------|-----------------|-----------------|
| 1 USD | 0.7257 | 0.7570 |
| 1 CHF | 0.8156 | 0.8282 |
| 1 GBP | 1.1976 | 1.2240 |

3.3. Pasuritë financiare dhe detyrimet financiare

(i) Njohja

Banka fillimisht njeh kreditë dhe paradhëniet, depozitat dhe detyrimet e varura në datën në të cilën ato janë krijuar. Të gjitha instrumentet tjera financiare (përfshirë blerjet e rregullta dhe shitjet e pasurive financiare) njihen në datën e tregimit, që është data në të cilën Banka bëhet palë në dispozitat kontraktuale të instrumentit.

Pasuria financiare ose detyrimi financiar matet fillimisht me vlerën e drejtë plus, për zërin që nuk është me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes, kostot e transaksionit që i atribuohen direkt blerjes apo lëshimit.

(ii) Klasifikimi

Pasuritë financiare

Banka i klasifikon pasuritë e veta financiare në një nga kategoritë e mëposhtme:

- Kreditë dhe paradhëniet;
- Të mbajtura deri në maturim;
- Në vlerë të drejtë përmes fitimit ose humbjes;
- Në dispozicion për shitje.

Shih 3.3.1 deri 3.3.7

Detyrimet financiare

Banka i klasifikon detyrimet e veta financiare, që nuk janë garanci financiare dhe zotimet e kredive, si të matura në bazë të kostos së amortizuar. Shih 3.3.1 dhe 3.3.5

(iii) Çregjistrimi

Pasuritë financiare

Banka e çregjistron një pasuri financiare kur të drejtat kontraktuese mbi hyrjen e parasë nga pasuria financiare mbarojnë, ose kur transferon të drejtat për të marrë rrjedhat monetare kontraktuese në një transaksion në të cilin kryesisht të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë të pasurisë financiare janë transferuar apo në të cilin Banka as nuk transferon, as nuk mban të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë dhe nuk e mban kontrollin e pasurisë financiare.

Në çregjistrimin e pasurisë financiare, diferenca ndërmjet vlerës bartëse të pasurisë (ose vlera e bartur e ndarë për pjesën e pasurisë që po çregjistrohet) dhe shumës së (i) shumës së arkëtuar (përfshirë çdo pasuri të re të përfituar minus detyrimin e ri të marrë përsipër) dhe (ii) fitimit ose humbjes kumulative që është njohur në të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse, njihet në fitim ose humbje. Çdo interes në pasuritë financiare të transferuara që kualifikohen për çregjistrim që krijohet ose mbahet nga Banka njihet si pasuri apo detyrim i veçantë.

Detyrimet financiare

Banka i çregjistron detyrimet financiare kur obligimet e veta kontraktuese përfundojnë apo anulohen, apo u skadon afati.

(iv) Kompensimi reciprok

Pasuritë financiare dhe detyrimet financiare kompensohen reciprokisht dhe shuma neto paraqitet në bilanc kur, dhe vetëm kur, Banka ka të drejtë ligjore për të kompensuar shumat reciprokisht dhe synon ose t'i shlyejë ato në bazë neto ose të realizojë pasurinë dhe ta shlyejë detyrimin njëkohësisht.

Të ardhurat dhe shpenzimet paraqiten në bazë neto vetëm atëherë kur lejohet sipas SNRF.

(v) Matja e kostos së amortizuar

"Kostoja e amortizuar" e një pasurie financiare ose detyrimi financiar është shuma me të cilën pasuria financiare ose detyrimi financiar matet në momentin fillestar minus pagesat e kapitalit, plus ose minus amortizimi i akumuluar duke përdorur metodën e interesit efektiv të diferencave ndërmjet shumës fillestare të njohur dhe shumës në maturitet, minus zbritjet eventuale për shkak të dëmtimit.

(vi) Matja e vlerës së drejtë

Politika e zbatuar nga 1 janari 2013

"Vlera e drejtë" është çmimi që do të merrej nëse shitet një pasuri ose që do të paguhej për të transferuar një detyrim në një transaksion të rregullt ndërmjet pjesëmarrësve të tregut në datën e matjes në tregun kryesor ose, në mungesë të tij, tregun më të favorshëm në të cilin Banka ka qasje në atë datë. Vlera e drejtë e detyrimit pasqyron rrezikun e mosperformancës së tij.

Kur mundet, Banka mat vlerën e drejtë të një instrumenti duke përdorur çmimin e kuotuar në një treg aktiv për atë instrument. Tregu konsiderohet aktiv nëse transaksionet e pasurisë ose detyrimit zhvillohen me frekuencë dhe vëllim të mjaftueshëm për të ofruar informata për çmimet në bazë të vazhdueshme. Nëse nuk ka çmim të kuotuar në një treg aktiv, atëherë Banka përdor teknika vlerësimi që maksimizojnë përdorimin e faktorëve përkatës të vëzhgueshëm dhe minimizojnë përdorimin e faktorëve jo të vëzhgueshëm. Teknika e zgjedhur e vlerësimit përfshin të gjithë faktorët që pjesëmarrësit e tregut do të merrnin parasysh gjatë vendosjes së çmimit të një transaksioni.

Dëshmia më e mirë e vlerës së drejtë të një instrumenti financiar në njohjen fillestare është zakonisht çmimi i transaksionit - dmth vlera e drejtë e shumës së dhënë ose të marrë.

Nëse banka përcakton se vlera e drejtë në njohjen fillestare ndryshon nga çmimi i transaksionit dhe vlera e drejtë nuk dëshmohet as me çmim të kuotuar në treg aktiv për një pasuri ose detyrim identik dhe as në bazë të një teknike vlerësimi që përdor vetëm të dhëna nga tregje të vëzhgueshme, atëherë instrumenti financiar matet fillimisht me vlerën e drejtë, të korrigjuar për të shtyrë dallimin ndërmjet vlerës së drejtë në njohjen fillestare dhe çmimit të transaksionit. Mandej, ky dallim njihet në fitim ose humbje në një bazë të përshtatshme përgjatë jetës së instrumentit, por jo më vonë se kur vlerësimi përkrahet plotësisht nga të dhëna të vëzhgueshme të tregut ose kur transaksioni të mbyllet. Në qoftë se një pasuri ose detyrim i matur me vlerën e drejtë ka një çmim të ofertës dhe një çmim të kërkesës, atëherë Banka mat pasuritë dhe pozicionet e gjata me çmimin e ofertës dhe detyrimet dhe qëndrimet e shkurtra me çmimin e kërkesës.

Vlera e drejtë e depozitës sipas kërkesës nuk është më pak se shuma e pagueshme sipas kërkesës, e skontuar nga data e parë në të cilën shuma mund të kërkohet për t'u paguar. Banka njih transferet ndërmjet niveleve të hierarkisë së vlerës së drejtë deri në fund të periudhës raportuese në të cilën ka ndodhur ndryshimi.

Politika e zbatuar para 1 janarit 2013

'Vlera e drejtë' është shuma me të cilën një pasuri mund të shkëmbehet, ose një detyrim të shlyhet, ndërmjet palëve me njohuri dhe vullnetshëm në një transaksion në kushte të tregut të lirë në datën e matjes.

Kur mundet, Banka mat vlerën e drejtë të një instrumenti duke përdorur çmimet e kuotuar në një treg aktiv për atë instrument. Një treg quhet aktiv në qoftë se çmimet e kuotuar janë të gatshme dhe në dispozicion dhe paraqesin transaksionet aktuale të rregullta të tregut në kushte të lira tregu. Nëse tregu për një instrument financiar nuk është aktiv, atëherë Banka përcakton vlerën e drejtë duke përdorur një teknikë vlerësimi. Teknika e zgjedhur e vlerësimit shfrytëzon në maksimum faktorët e tregut, mbështetet sa më pak të jetë e mundur në vlerësimet specifike të Bankës, përfshin të gjithë faktorët që pjesëmarrësit e tregut do të merrnin parasysh në caktimin e çmimit dhe është në përputhje me metodologjitë ekonomike të pranuar për vlerësimin e instrumenteve financiare.

Dëshmia më e mirë e vlerës së drejtë të një instrumenti financiar në njohjen fillestare është çmimi i transaksionit - dmth vlera e drejtë e shumës së dhënë ose të marrë. Megjithatë, në disa raste vlerësimi fillestar i vlerës së drejtë të një instrumenti financiar

në njohjen fillestare mund të jetë ndryshe nga çmimi i transaksionit. Nëse kjo vlerë e drejtë e vlerësuar dëshmohej nga krahasimi me transaksione tjera aktuale të tregut për të njëjtin instrument (pa modifikim ose ripërpunim) ose bazuar në një teknikë vlerësimi variablat e të cilës përfshijnë vetëm të dhëna nga tregje të vëzhgueshme, mandej diferenca njihet në fitim ose humbje në njohjen fillestare të instrumentit. Në raste të tjera, vlera e drejtë në njohjen fillestare konsiderohet të jetë çmimi i transaksionit dhe dallimi nuk njihet në fitim ose humbje menjëherë, por njihet përgjatë jetës së instrumentit në ndonjë bazë të duhur, ose kur instrumenti të rimerret, transferohet apo shitet, ose kur vlera e drejtë të bëhet e qartë.

Në qoftë se një pasuri ose detyrim i matur me vlerën e drejtë ka një çmim të ofertës dhe një çmim të kërkesës, atëherë Banka mat pasuritë dhe pozicionet e gjata me çmimin e ofertës dhe detyrimet dhe pozicionet e shkurtra me çmimin e kërkesës. Kur Banka ka pozicione me rreziqe që kompensohen reciprokisht, përdoren çmimet e mesme të tregut për të matur pozicionin e rrezikut të kompensimit dhe zbatohet korrigjimi i çmimit të ofertës ose kërkesës vetëm në pozicionin e hapur neto.

Vlera e drejtë e një depozite të kërkesës është jo më pak se shumta e pagueshme sipas kërkesës, e skontuar nga dita e parë në të cilën shumta mund të kërkohet për t'u paguar.

(vii) Identifikimi dhe matja e dëmtimit

Dëmtimi i kredive dhe paradhënieve

Banka vlerëson në çdo datë raportimi nëse ka dëshmi objektive që një pasuri financiare ose grup pasurish financiare është e dëmtuar. Pasuria financiare ose një grup pasurish financiare është e dëmtuar vetëm nëse ka dëshmi objektive të dëmtimit si rezultat i një apo më shumë ngjarjeve që kanë ndodhur pas njohjes fillestare të pasurisë ('humbje') dhe që kjo humbje (ose humbjet) ka një ndikim në rrjedhat e vlerësuar të ardhshme të parave të pasurisë financiare ose grupit të pasurive financiare që mund të vlerësohen në mënyrë të besueshme.

Kriteret që Banka përdor për të përcaktuar se ka dëshmi objektive të humbjes nga dëmtimi përfshijnë:

- Mospagesa për pagesat me kontratë të kapitalit ose interesit;
- Vështirësi për huamarrësin në rrjedhën e tij të parave;
- Shkelja e kushteve të kredisë;
- Inicimi i procedurave të bankrotimit;
- Përkeqësimi i gjendjes konkurruese të huamarrësit;
- Përkeqësimi i vlerës së kolateralit;

Periudha e vlerësuar ndërmjet humbjeve që ndodhin dhe identifikimi i saj përcaktohet nga menaxhmenti lokal për çdo portfolio të identifikuar. Në përgjithësi, periudhat e përdorura ndryshojnë nga tre muaj deri në 12 muaj, në raste të jashtëzakonshme, jepen periudha më të gjata.

Banka së pari vlerëson nëse dëshmia objektive e dëmtimit ekziston individualisht për pasuritë financiare që janë individualisht të rëndësishme, dhe individualisht ose kolektivisht për pasuritë financiare të cilat nuk janë individualisht të rëndësishme. Nëse Banka përcakton se nuk ka dëshmi objektive të dëmtimit për një pasuri financiare të vlerësuar individualisht, qoftë e rëndësishme ose jo, ajo e përfshin pasurinë në një grup pasurish financiare me karakteristika të ngjashme të rrezikut kreditor dhe vlerëson në mënyrë kolektive dëmtimin e tyre. Pasuritë që janë vlerësuar individualisht nëse kanë dëmtim dhe për të cilat ka ose vazhdon të njihet humbja nga dëmtimi, nuk përfshihen në vlerësim kolektiv të dëmtimit.

Shuma e humbjes matet si diferenca ndërmjet vlerës së bartur të pasurisë dhe vlerës aktuale të rrjedhave të ardhshme të parave (duke përfshirë humbjet e ardhshme kreditore që nuk kanë ndodhur) të skontuar me normën fillestare të interesit efektiv të pasurisë financiare. Vlera e bartur e pasurisë zvogëlohet nëpërmjet përdorimit të një llogarie të zbritjes dhe shumta e humbjes njihet në pasqyrën e fitimit dhe humbjes.

Llogaritja e vlerës së tashme të rrjedhave të ardhshme të vlerësuar të parave të një pasurie financiare të kolateralizuar pasqyron rrjedhat e parave që mund të rezultojnë nga mbyllja e kolateralit minus kostot për marrjen dhe shitjen e kolateralit, qoftë mbyllje a mundshme apo jo. Për qëllimet e një vlerësimi kolektiv të dëmtimit, pasuritë financiare grupohen në bazë të karakteristikave të ngjashme të rrezikut kreditor (dmth., në bazë të procesit të vlerësimit të Bankës që shqyrton llojin e pasurisë, industrinë, vendndodhjen gjeografike, llojin e kolateralit, statusin e kaluar dhe faktorë të tjerë përkatës). Këto karakteristika janë të rëndësishme për vlerësimin e rrjedhave të ardhshme të parave për grupet e pasurive që janë tregues të aftësisë së debitorit për të paguar të gjitha shumtat sipas kushteve kontraktuale të pasurive që janë duke u vlerësuar.

Rrjedhat e parave të ardhshme në një grup të pasurive financiare që vlerësohen në mënyrë kolektive për dëmtim, vlerësohen në bazë të rrjedhave të parave kontraktuale të pasurive të Bankës dhe përvojës së humbjes historike nga pasuritë me karakteristika të rrezikut kreditor të ngjashme me ato në Bankë. Përvoja e humbjes historike rregullohet në bazë të të dhënave aktuale të vëzhguara për të pasqyruar efektet e kushteve aktuale, që nuk e kanë prekur periudhën në të cilën është e bazuar përvoja historike e humbjes dhe për të hequr efektet e kushteve të periudhës historike që nuk ekzistojnë aktualisht.

Vlerësimet e ndryshimeve në rrjedhat e ardhshme të parasë për grupe të pasurive pasqyrojnë dhe janë në përputhje me ndryshimet në të dhënat përkatëse të vëzhguara nga periudha në periudhë (për shembull, ndryshimet në normat e papunësisë, çmimet e pronës, statusin e pagesave, apo faktorë të tjerë tregues të ndryshimeve në probabilitetin e humbjeve në Banka dhe madhësia e tyre). Metodologjia dhe supozimet e përdorura për vlerësimin e rrjedhave të parave të ardhshme rishikohen rregullisht nga Banka për të zvogëluar dallimet ndërmjet vlerësimit të humbjeve dhe përvojës aktuale të humbjeve.

Kur një kredi është e pakthyeshme, ajo shlyhet kundrejt provizionit për dëmtim të kredisë. Kredi të tilla shlyhen pasi të gjitha procedurat e nevojshme kanë përfunduar dhe shuma e humbjes është përcaktuar.

Në qoftë se, në një periudhë të mëvonshme, shuma e dëmtimit të humbjes zvogëlohet dhe zvogëlimi lidhet objektivisht me një ngjarje që ndodh pasi është njohur dëmtimi (siç mund të jetë përmirësimi i vlerësimit kreditor të debitorit), humbja nga dëmtimi e njohur më parë stornohet duke rregulluar llogarinë e zbritjes. Shuma e stornimit njihet në pasqyrën e fitimit dhe humbjes kundrejt dëmtimit të ngarkuar për humbjet e kredisë.

Dëmtimi i pasurive financiare në dispozicion për shitje

Banka vlerëson në çdo datë raportimi nëse ka dëshmi objektive që një pasuri financiare ose një grup pasurish financiare është dëmtuar. Në rastin e investimeve të borxhit të klasifikuara si në dispozicion për shitje, një rënie e madhe ose e zgjatur në vlerën e drejtë të instrumentit nën koston e tij merret parasysh në përcaktimin nëse pasuritë janë dëmtuar. Në qoftë se këto dëshmi ekzistojnë për pasuritë financiare në dispozicion për shitje, humbja kumulative - e matur si diferenca ndërmjet koston së blerjes dhe vlerës aktuale të drejtë, minus ndonjë humbje nga dëmtimi i asaj pasurie financiare të njohur më parë në fitim ose humbje – hiqet nga të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse dhe njihet në fitim ose humbje. Në qoftë se, në një periudhë të mëvonshme, vlera e drejtë e një instrumenti të borxhit, i klasifikuar si në dispozicion për shitje, rritet dhe rritja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje që ndodh pasi humbja nga dëmtimi është njohur në fitim ose humbje, humbja nga dëmtimi anulohet nëpërmjet fitimit dhe humbjes.

3.3.1. Pasuritë financiare në vlerë të drejtë përmes fitimit dhe humbjes

Kjo kategori ka dy nën-kategori: pasuritë financiare të mbajtura për tregtim ("pasuritë tregtare"), duke përfshirë instrumentet derivative të mbajtura, dhe pasuritë financiare të përcaktuara në fillim me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes. Banka nuk zbaton kontabilitetin mbrojtës. Banka ka përcaktuar pasuritë financiare dhe detyrimet financiare me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes në cilëndo nga rrethanat e mëposhtme:

- Pasuritë ose detyrimet menaxhohen, vlerësohen dhe raportohen në bazën e vlerës së drejtë;
- Përcaktimi eliminon ose ul ndjeshëm mospërputhjet kontabël që do të lindnin përndryshe;

Kjo kategori ka dy nën-kategori: pasuri financiare të mbajtura për tregtim, dhe ato të përcaktuara në fillim me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes.

a) Pasuritë financiare që mbahen për tregti

Pasuria financiare klasifikohet si e mbajtur për tregtim në qoftë se ajo është blerë ose krijuar kryesisht për qëllimin e shitjes ose riblerjes në periudhën afatshkurtër, ose në qoftë se ajo është pjesë e një portfolio të instrumenteve financiare të identifikuar që menaxhohen së bashku dhe për të cilat ka dëshmi të një modeli aktual të fitimeve afatshkurtra. Edhe instrumentet derivative kategorizohen si të mbajtura për tregtim nëse ato përcaktohen si instrumente mbrojtëse (hedging instruments).

b) Të caktuara në vlerë të drejtë përmes fitimit dhe humbjes

Pasuritë financiare dhe detyrimet financiare përcaktohen me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes kur:

- Kjo konsiderueshëm i zvogëlon mospërputhjet e matjes që do të lindnin, nëse instrumentet e lidhura trajtohen si të mbajtura për tregtim dhe instrumentet financiare bazë regjistrohen në koston e amortizuar për kreditë dhe paradhënie për klientët apo bankat dhe letrat me vlerë të lëshuara;
- Disa investime, të tilla si investimet e kapitalit, menaxhohen dhe vlerësohen mbi bazën e vlerës së drejtë në përputhje me një strategji të dokumentuar të rrezikut ose investimit dhe të raportuar te personeli kryesor i menaxhmentit në atë bazë dhe përcaktohen me vlerë të drejtë përmes fitimit dhe humbjes, dhe
- Instrumentet financiare, të tilla si letra me vlerë të borxhit, që përmbajnë një ose më shumë instrumente derivative të përfshira që konsiderueshëm modifikojnë rrjedhën e parave, përcaktohen me vlerë të drejtë përmes fitimit dhe humbjes.

3.3.2. Pasuritë financiare në dispozicion për shitje

Investimet në dispozicion për shitje janë investime jo-derivative që përcaktohen si në dispozicion për shitje ose nuk janë klasifikuar si një kategori tjetër e pasurive financiare. Investimet në dispozicion për shitje përfshijnë aksionet e kapitalit dhe instrumentet e borxhit. Aksionet e kapitalit që nuk janë kuotuar dhe vlera e drejtë e të cilave nuk mund të matet në mënyrë të besueshme barten sipas koston. Të gjitha investimet e tjera në dispozicion për shitje maten me vlerën e drejtë pas njohjes fillestare.

Të ardhurat nga interesi njihen në fitim ose humbje duke përdorur metodën e interesit efektiv. Të ardhurat nga dividendët njihen në fitim ose humbje kur Banka fiton të drejtën për dividend. Fitimet ose humbjet nga këmbimet valutore të investimeve në dispozicion për shitje të borxhit njihen në fitim ose humbje. Humbjet nga dëmtimi njihen në fitim ose humbje.

Ndryshimet në vlerën e drejtë, që nuk janë humbjet nga dëmtimi njihen në të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse dhe paraqiten në rezervën e vlerës së drejtë brenda kapitalit. Kur investimi shitet, fitimi ose humbja e akumuluar në ekuitet riklasifikohet në fitim ose humbje.

3.3.3. Kreditë dhe paradhëniet

Kreditë dhe të arkëtueshmet janë pasuri financiare jo-derivative me pagesa fikse ose të përcaktueshme, të cilat nuk kuotohen në treg aktiv. Kreditë dhe paradhëniet për bankat dhe kreditë dhe paradhëniet për klientët klasifikohen si kredi dhe llogari të arkëtueshme.

Të gjitha kreditë dhe paradhëniet njihen fillimisht me vlerën e drejtë, që janë paratë e dhëna si paradhënie për huamar-rësit. Pas njohjes fillestare, ato maten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e normës efektive të interesit. Kosto e amortizuar llogaritet duke marrë parasysh koston e lëshimit dhe ndonjë zbritje ose premium për pagesë.

Kreditë dhe paradhëniet raportohen neto nga provizionet për humbje nga kreditë.

Kur Banka blen një pasuri financiare dhe njëherësh hyn në një marrëveshje për ta rishitur këtë pasuri (ose një pasuri kryesisht të ngjashme) me një çmim fiks në një datë të ardhshme (repo e anasjelltë), marrëveshja regjistrohet si kredi apo paradhënie, dhe pasuria nuk paraqitet në pasqyrat financiare të Bankës.

3.3.4. Investimet e mbajtura deri në maturim

Investime të mbajtura deri në maturim, janë investimet në obligacionet e qeverisë që Banka ka qëllimin dhe aftësinë për t'i mbajtur deri në maturim. Investimet e mbajtura deri në maturim barten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv, minus humbjet nga dëmtimi. Shitja ose riklasifikimi i shumës më të madhe të investimeve të mbajtura deri në maturim do të kishin si rezultat riklasifikimin e të gjitha investimeve të mbajtura deri në maturim si në dispozicion për shitje, dhe Banka nuk do të mund të klasifikonte investimet si të mbajtura deri në maturim gjatë periudhës aktuale dhe gjatë dy viteve financiare të ardhshme.

3.3.5. Instrumentet financiare derivateve

Instrumentet derivative njihen fillimisht me vlerën e drejtë në datën në të cilën lidhet kontrata derivative dhe më pas maten me vlerën e tyre të drejtë. Vlerat e drejta merren nga çmimet e kuotuar të tregut në tregje aktive, duke përfshirë edhe transaksionet e fundit të tregut, dhe teknikat e vlerësimit, duke përfshirë modele të rrjedhave të skontuara të parasë sipas rastit. Të gjithë derivativët barten si pasuri kur vlera e drejtë është pozitive dhe si detyrime kur vlera e drejtë është negative. Fitimet dhe humbjet që rrjedhin nga ndryshimet në vlerën e drejtë të derivativëve përfshihen në "Fitimet dhe humbjet nga letrat me vlerë të investimeve" në fitimin ose humbjen e periudhës.

Banka përdor instrumentet financiare derivative si opcionet e normave të interesit që blihen në treg (OTC) dhe kontratat para-prake të valutës së huaj për t'u mbrojtur nga rreziku që rrjedh nga luhatjet e normave të interesit të tregut dhe luhatjet e valutës së huaj. Për instrumentet derivative nuk zbatohet kontabiliteti mbrojtës. Instrumentet derivative financiare njihen fillimisht me vlerën e drejtë në datën në të cilën kontrata derivative hyn në fuqi dhe më pas maten me vlerën e drejtë dhe ndryshimi në vlerën e drejtë njihet në fitim ose humbje.

3.3.6. Paraja dhe ekuivalentët e parasë

Paraja dhe ekuivalentët e saj përfshijnë kartëmonedhat, monedhat, bilancet e pakushtëzuara bankare të mbajtura në bankat qendrore dhe pasuritë financiare afatshkurtra me maturitet fillestar tre muaj ose më pak nga data e blerjes që janë objekt i një rreziku të parëndësishëm të ndryshimeve në vlerën e drejtë, dhe përdoren nga Banka në menaxhimin e zotimeve afatshkurtra. Paraja dhe ekuivalentët e saj mbahen sipas koston së amortizuar në pasqyrën e bilancit financiar.

3.3.7. Rezervat e detyrueshme të likuiditetit

Në përputhje me rregullat e BQK-së, Banka duhet të përmbushë kërkesën mesatare minimale të likuiditetit. Kërkesa e likuiditetit llogaritet në baza javore si 10% e bazës së depozitave, e përcaktuar si mesatare e gjithsej detyrimeve të depozitave për publikun jo-bankar në EURO dhe valuta të tjera, gjatë ditëve të punës së periudhës së mirëmbajtjes. Pasuritë me të cilat Banka mund të plotësojë kërkesat e likuiditetit janë depozitat në EURO në BQK dhe 50% të EUR ekuivalentit të parave të gatshme në valutat lehtësisht të konvertueshme. Depozitat në BQK nuk duhet të jenë më pak se 5% e bazës së zbatueshme të depozitave. Përderisa pasuritë përkatëse likuide nuk janë në dispozicion për të financuar aktivitetet e përditshme të Bankës, ato janë përjashtuar nga paraja dhe ekuivalentët e parasë për qëllime të pasqyrës së rrjedhjes së parasë.

3.4. Përmirësimet e pronës së mbajtur me qira dhe pajisjet

Përmirësimet e objekteve me qira dhe pajisjet paraqiten me koston historike minus amortizimin e akumuluar dhe dëmtimin e akumuluar, nëse ka. Kostoja historike përfshin shpenzimet që i atribuohen drejtpërdrejt blerjes së artikujve të përmirësimeve të pronës me qira dhe pajisjeve.

Kostot pasuese përfshihen në vlerën bartëse të pasurisë apo njihen si pasuri të ndara, sipas rastit, vetëm kur është e mundur që përfitimet ekonomike të ardhshme të lidhura me artikullin do të rrjedhin në Bankë dhe kostoja e artikullit mund të matet me besueshmëri. Të gjitha riparimet dhe mirëmbajtjet tjera i ngarkohen shpenzimeve tjera operative gjatë periudhës financiare në të cilën kanë ndodhur.

Vlerat bartëse të përmirësimeve të pronës me qira dhe pajisjeve rishikohen për dëmtime kur ngjarjet ndryshojnë apo ndryshimet në rrethana tregojnë se vlera e bartur mund të mos jetë e realizueshme. Nëse ka indikacione të tilla dhe ku vlerat bartëse tejkalojnë shumën që vlerësohet të merret, pasuritë ose njësitë gjeneruese të parasë shlyhen deri në vlerën e tyre të realizueshme.

Shuma e realizueshme e përmirësimeve të pronës me qira dhe pajisjeve është më e larta ndërmjet vlerës së drejtë minus kostot e shitjes dhe vlera në përdorim. Në vlerësimin e vlerës në përdorim, rrjedhat e ardhshme të parasë skontojnë në vlerën e tyre aktuale duke përdorur një normë skontimi para taksave që pasqyron vlerësimin aktual të tregut të vlerës kohore të parasë dhe rreziqet specifike për ato pasuri.

Për një pasuri që nuk krijon rrjedha të parasë të pavarura, shumën e realizueshme përcaktohet për njësinë krijuese të parasë të cilës i përkasin pasuritë. Humbjet nga dëmtimi njihen në pasqyrën e fitimit dhe humbjes dhe të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse.

Zhvlerësimi i pasurive ngarkohet në bazë të metodës lineare në normat e përcaktuara për të shpërndarë koston e pronës dhe pajisjeve mbi jetëgjatësinë e përdorimit. Normat vjetore të amortizimit përcaktohen nga jetëgjatësia e vlerësuar e pasurive të caktuara sipas tabelës më poshtë:

| | |
|--|--------|
| Përmirësimet e pronës me qira zhvlerësohen mbi më të ulëtën ndërmjet jetëgjatësisë dhe afatit të qirasë. | |
| Bankomatët, pajisjet tjera të bankës dhe zyrës & serverët e TI | 5 vjet |
| Pajisjet kompjuterike | 3 vjet |

Metodat e zhvlerësimit, jetëgjatësia dhe vlera e mbetur rishikohen në datën e raportimit.

3.5. Pasuritë e paprekshme

Pasuritë e paprekshme njihen nëse është e mundur që përfitimet ekonomike në të ardhmen që i atribuohen pasurisë do të hyjnë në Bankë dhe kostoja e pasurisë mund të matet me besueshmëri. Pasuritë e paprekshme fillimisht maten me kosto. Vlerat kontabël të pasurive të paprekshme rishikohen për dëmtim, kur ngjarjet apo ndryshimet në rrethana tregojnë që vlera bartëse nuk mund të realizohet. Pasuritë e paprekshme përbëhen tërësisht nga programe kompjuterike që amortizohen duke përdorur metodën lineare gjatë jetëgjatësisë së tyre të vlerësuar pesë vjet dhe licencave që amortizohen gjatë afatit të licencës.

3.6. Prona e rimarrë në posedim

Në rrethana të caktuara, prona rimerret në posedim pas mbylljes së kredive që nuk janë paguar. Prona e marrë në ripozedim matet nga 1.000 euro secila dhe regjistrohen në "Pasuri tjera". Qëllimi i menaxhmentit për pronat që merren në ripozedim është për t'i shitur sa më shpejt të jetë e mundur, dhe të ardhurat të përdoren për të ulur borxhin e papaguar.

3.7. Huamarrjet

Huamarrjet njihen fillimisht me kosto, neto nga shpenzimet e transaksioneve të kryera. Huamarrjet deklarohen më pas me koston e amortizuar; ndonjë dallim ndërmjet të ardhurave neto nga kostot e transaksionit dhe vlerës së kthimit njihen në fitim ose humbje gjatë periudhës së huamarrjes duke përdorur metodën e interesit efektiv.

3.8. Provizionet

Provizionet njihen nëse, si rezultat i ngjarjeve të mëparshme, Banka ka një detyrim ligjor ose të krijuar që mund të matet me besueshmëri, dhe është e mundur që të mira ekonomike do të harxhohen për të mbuluar detyrimin. Provizionet përcaktohen duke skontuar rrjedhat e ardhshme të parasë me një normë para tatimit që pasqyron vlerësimin aktual të tregut për vlerën kohore të parasë dhe rreziqet specifike ndaj detyrimit. Lëshimi i skontimit njihet si kosto financiare.

Detyrimet kontigjente mund të zhvillohen në një mënyrë që nuk është pritur fillimisht. Prandaj ato vlerësohen vazhdimisht për të përcaktuar nëse dalja e burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike është bërë e mundur. Në rast se detyrimi kontigjent ka si rezultat një detyrim aktual që mund të matet me besueshmëri, duhet të regjistrohet provizioni për shumën. Vetëm zotimet e pakthyeshme shkaktojnë rrezik kreditor, pra vetëm kontigjencat dhe zotimet e pakthyeshme mund të jenë objekt i provizionit. Për ekspozimet e mëdha, vlerësimi bëhet në mënyrë individuale. Në rast të vlerësimit të portfolios, ndërtimi i portfolios dhe llogaritja e provizioneve të bazuara në portfolio llogariten siç tregohet në dëmtimin e kredive dhe paradhënieve.

3.9. Beneficionet e punëtorëve

Banka paguan vetëm kontributet për planin pensional të detyrueshëm të administruar publikisht. Banka nuk ka detyrime tjera për pagesa pasi janë paguar kontributet. Kontributet njihet si shpenzim i beneficioneve të punëtorëve në kohën kur ato duhet të paguhen.

3.10. Kapitali aksionar

Dividendat në aksionet e zakonshme

Dividendët në aksionet e zakonshme njihen në ekuitet në periudhën në të cilën ato janë aprovuar nga aksionarët e bankës. Dividendët për vitin që janë deklaruar pas datës së raportimit shpalosen si ngjarje pas fundit të periudhës së raportimit.

3.11. Të ardhurat dhe shpenzimet nga interesi

Të ardhurat dhe shpenzimet nga interesi për të gjitha instrumentet financiare që bartin interes njihen në fitim ose humbje të periudhës në 'të ardhurat e interesit' dhe 'shpenzimet e interesit' duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Metoda e interesit efektiv është një metodë e llogaritjes së koston të amortizuar të një pasurie financiare ose një detyrimi financiar dhe e shpërndarjes së të ardhurave nga interesi ose shpenzimeve nga interesi në periudhën përkatëse. Norma e interesit efektiv është norma që zbrit saktësisht pagesat e ardhshme ose arkëtimet përgjatë jetëgjatësisë së pritit të instrumentit financiar ose, kur është e përshtatshme, një periudhë më të shkurtër për vlerën bartëse neto të pasurisë financiare ose detyrimit financiar. Gjatë llogaritjes së normës efektive të interesit, Banka vlerëson rrjedhat e parave duke marrë parasysh të gjitha kushtet kontraktuale të instrumentit financiar, por nuk merr parasysh humbjet e ardhshme kreditore. Llogaritja e normës së interesit efektiv përfshin kostot e transaksionit dhe tarifën dhe pagesat e paguara ose të pranuar që janë pjesë përbërëse e normës efektive të interesit. Kostot e transaksioneve përfshijnë koston shtesë të lidhura drejtpërdrejt me blerjen ose emetimin e një pasurie financiare ose detyrimi financiar. Të ardhurat dhe shpenzimet nga interesi të paraqitura në pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse përfshijnë:

- Interesin në pasuritë financiare dhe detyrimet financiare të matur në koston të amortizuar të llogaritur në bazë të interesit efektiv; dhe
- Interesin në letrat me vlerë të investimeve në dispozicion për shitje të llogaritur në bazë të interesit efektiv.

3.12. Tarifat dhe komisionet

Të ardhurat dhe shpenzimet nga tarifën dhe komisionet të cilat janë pjesë përbërëse e normës së interesit efektiv për një pasuri financiare ose detyrim financiar, përfshihen në matjen e normës së interesit efektiv.

Të ardhurat tjera nga komisionet - duke përfshirë tarifën e shërbimeve të llogarisë, komisionet e shitjeve, tarifën e plasimit - njihen kur shërbimet përkatëse të kryhen. Në qoftë se një zotim për kredi nuk pritet të ketë si rezultat tërheqjen e një kredie, atëherë tarifën përkatëse të zotimit të kredisë njihen në bazë lineare gjatë periudhës së zotimit.

Shpenzimet tjera për komisionet dhe tarifën lidhen kryesisht me tarifën transaksionesh ose shërbimesh të cilat shpenzohen në momentin që pranohen shërbimet.

3.13. Qiratë operative

Pagesat e bëra për qira operative ngarkohen në shpenzime në bazë të metodës lineare gjatë jetëgjatësisë së qirasë. Kur një qira e zakonshme përfundon para kohës së përfundimit të qirasë, pagesat që kërkohet të bëhen për qiradhënësin si dënim njihen si shpenzim në periudhën në të cilën ndodh ndërprerja.

3.14. Tatimi në të ardhura

Tatimi në të ardhura përfshin tatimin aktual dhe të shtyrë. Ai njihet në fitim ose humbje me përjashtim të pjesës që lidhet me zëra të njohur direkt në kapital ose në të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse.

Tatimi aktual

Tatimi aktual përfshin tatimin që pritet të paguhet ose arkëtohet mbi fitimin e tatueshëm ose humbjen e vitit dhe korrigjimet e tatimit të pagueshëm ose të arkëtueshëm në lidhje me vitet e mëparshme. Ai matet duke përdorur normat tatimore në fuqi në datën e raportimit.

Tatimi i shtyrë

Tatimi i shtyrë njihet në përputhje me diferencat e përkohshme ndërmjet vlerës bartëse të pasurive dhe detyrimeve për qëllime raportimi financiar dhe shumave të përdorura për qëllime tatimore.

Tatimi i shtyrë matet me norma të tatimit që pritet të zbatohen ndaj diferencave të përkohshme kur ato të kthehen prapa, në bazë të ligjeve që janë miratuar ose substantivisht janë miratuar në datën e raportimit. Pasuria tatimore e shtyrë njihet vetëm nëse është e mundur që fitimi i tatueshëm i ardhshëm do të jetë në dispozicion kundrejt të cilit mund të përdoren diferencat e përkohshme të zbritshme. Detyrimet e shtyra tatimore njihen për të gjitha diferencat e përkohshme të tatueshme. Pasuritë tatimore të shtyra dhe detyrimet tatimore të shtyra rishikohen në çdo datë raportimi dhe zvogëlohen nëse nuk është më e mundur që përfitimet nga tatimi dhe përkatësisht detyrimi tatimor do të realizohen.

Tatimet shtesë mbi të ardhura që shfaqen nga shpërndarja e dividendëve njihen në të njëjtën kohë kur njihet detyrimi për ta paguar dividendin përkatës.

3.15. Ndryshimet në politikat kontabël

Banka ka miratuar standardet e mëposhtme të reja dhe ndryshimet e standardeve, duke përfshirë ndryshimet pasuese në standardet tjera, me datën e zbatimit fillestar 1 janar 2013.

- a. SNRF 10 Pasqyrat financiare të konsoliduara (2011)
- b. SNRF 12 Shpalosja e interesit në njësitë tjera
- c. SNRF 13 Matja e vlerës së drejtë

Natyra dhe efektet e ndryshimeve janë shpjeguar më poshtë:

(a) Vartësit

Si rezultat i SNRF 10 (të vitit 2011), Banka ka ndryshuar politikën e saj kontabël për të përcaktuar nëse ka kontroll mbi njësitë tjera dhe si pasojë nëse ato i konsolidon. SNRF 10 (2011) paraqet një model të ri të kontrollit që përqendrohet në atë nëse Banka ka fuqi mbi një pranues të investimit, ekspozim ose të drejta mbi fitimin e ndryshueshëm nga përfshirja e saj me pranuesin e investimit dhe aftësinë për ta përdorur fuqinë e saj për të ndikuar në atë fitim. Në përputhje me dispozitat kalimtare të SNRF 10 (2011), Banka ka rivlerësuar konkluzionet e saj të kontrollit nga data 1 janar 2013. Ndryshimi nuk ka pasur ndikim në pasqyrat financiare të Bankës sepse përfundimi i konsolidimit nuk ka ndryshuar pas rivlerësimit.

(b) Interesi në njësitë tjera

Si rezultat i SNRF 12, Grupi ka zgjeruar shpalosjet rreth interesave të saj në vartës (shih Shënimi 11).

(c) Matja e vlerës së drejtë

Në përputhje me dispozitat kalimtare të SNRF 13, Banka ka zbatuar përkufizimin e ri të vlerës së drejtë, siç përcaktohet në shënimin 5, në mënyrë prospektive. Ndryshimi nuk ka pasur ndikim të rëndësishëm në matjen e pasurive dhe detyrimeve të Bankës.

3.16. Standardet e reja dhe interpretimet që ende nuk janë aprovuar

Një numër i standardeve të reja, ndryshimeve apo interpretimeve të tyre ende nuk janë në fuqi për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2013, dhe nuk janë zbatuar në përgatitjen e këtyre pasqyrave financiare. Ato që mund të jenë relevante për Bankën janë përcaktuar më poshtë. Banka nuk ka në plan të miratojë këto standarde më herët.

(i) SNRF 9 Instrumentet Financiare (2013), SNRF 9 Instrumentet Financiare (2010) dhe SNRF 9 Instrumentet Financiare (2009) (së bashku, SNRF 9)

SNRF 9 (2009) paraqet kërkesat e reja për klasifikimin dhe matjen e pasurive financiare. SNRF 9 (2010) paraqet plotësimet lidhur me detyrimet financiare. SNRF 9 (2013) paraqet kërkesat e reja për kontabilitetin mbrojtës. BNSF aktualisht ka një projekt aktiv për të bërë ndryshime të kufizuara në kërkesat e SNRF 9 për klasifikimin dhe matjen dhe shton kërkesa të reja për të trajtuar dëmtimin e pasurive financiare.

Kërkesat e SNRF 9 (2009) paraqesin një ndryshim të rëndësishëm nga kërkesat ekzistuese të SNK 39 në lidhje me pasuritë financiare. Standardi përmban dy kategori kryesore të matjes për pasuritë financiare: me kosto të amortizuara dhe vlerën e drejtë. Pasuria financiare matet me koston e amortizuara nëse mbahet brenda një modeli biznesi qëllimi i të cilit është që të mbajë pasuritë për të mbledhur rrjedhat kontraktuale të parave, dhe kushtet kontraktuale të pasurisë parashohin në data të përcaktuara rrjedha të parave që janë pagesa të kapitalit dhe të interesit mbi kapitalin e papaguar. Të gjitha pasuritë e tjera financiare do të maten me vlerën e drejtë. Standardi eliminon kategoritë ekzistuese të SNK 39 të mbajtura deri në maturim, në dispozicion për shitje dhe kreditë dhe llogaritë e arkëtueshme. Për investimet në instrument kapitali, që nuk mbahen për t'u tregtuar, standardi lejon zgjedhje të pakthyeshme, në njohjen fillestare, në bazë individuale sipas aksionit, për të paraqitur të

gjitha ndryshimet në vlerë të drejtë nga investimi, në të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse. Asnjë shumë e njohur në të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse nuk do të riklasifikohet në fitim ose humbje në një datë të mëvonshme.

Megjithatë, dividendët mbi investimet e tilla njihen në fitim ose humbje, dhe jo në të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse, përveç nëse në mënyrë të qartë përfaqësojnë rikthim të pjesshëm të kostos së investimit. Investimet në instrumentet e ekuitetit për të cilat njësitë ekonomike nuk ka zgjedhur të paraqesë ndryshimet e vlerës së drejtë në të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse maten me vlerën e drejtë dhe ndryshimet në vlerën e drejtë njihen në fitim ose humbje.

Standardi kërkon që instrumentet derivative të përfshira në kontrata ku kontrata është pasuri financiare në kuadër të standardit të mos ndahen, mirëpo, instrumenti hibrid financiar vlerësohet në tërësi nëse duhet të matet me koston e amortizuar ose vlerën e drejtë.

SNRF 9 (2010) paraqet një kërkesë të re në lidhje me detyrimet financiare të përcaktuara në bazë të opsionit të vlerës së drejtë që në përgjithësi të paraqesin ndryshimet në vlerën e drejtë që lidhen drejtpërdrejt me rrezikun e detyrimit të kredisë në të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse dhe jo në fitim ose humbje. Përveç këtij ndryshimi, SNRF 9 (2010) kryesisht vazhdon tujtë pa ndryshim substancial në udhëzimet për klasifikimin dhe matjen e detyrimeve financiare nga SNK 39.

SNRF 9 (2013) paraqet kërkesat e reja për kontabilitetin mbrojtës që harmonizon kontabilitetin mbrojtës më afër me menaxhimin e rrezikut. Kërkesat gjithashtu vendosin një qasje më shumë parimore për kontabilitetin mbrojtës dhe trajtojnë mospërputhjet dhe dobësitë në modelin e kontabilitetit mbrojtës në SNK 39.

Data e detyrueshme e hyrjes në fuqi të SNRF 9 nuk është specifikuar, por do të përcaktohet kur të finalizohen fazat e mbetura. Zbatimi i hershëm i SNRF 9 lejohet megjithatë. Banka ka filluar procesin e vlerësimit të efektit potencial të këtij standardi, por është në pritje të finalizimit të amendamenteve të kufizuara para se vlerësimi të përfundojë. Duke pasur parasysh natyrën e aktiviteteve të Bankës, ky standard pritet të ketë ndikim të shumanshëm në pasqyrat financiare të Bankës.

(ii) Kompensimi reciprok i pasurive financiare dhe detyrimeve financiare (Ndryshimet në SNK 32)

Ndryshimet e SNK 32 sqarojnë kriteret e kompensimit reciprok në SNK 32 duke shpjeguar kur një njësi ekonomike aktualisht ka të drejta ligjore për të kompensuar dhe kur pagesa bruto është e barabartë me pagesën neto. Ndryshimet janë në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më datën 1 janar 2014 ose pas kësaj date dhe periudhat e ndërmjetme brenda atyre periudhave vjetore. Zbatimi i hershëm është i lejuar.

Banka është ende duke vlerësuar efektin potencial të miratimit të ndryshimeve të SNK 32.

3.17. Vlerësimet kritike kontabël dhe burimet kryesore të pasigurisë së vlerësimit

Banka bën vlerësime dhe supozime të cilat ndikojnë në shumat e raportuara të pasurive dhe detyrimeve brenda vitit të ardhshëm financiar. Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen vazhdimisht dhe bazohen në përvojën historike dhe faktorë të tjerë, duke përfshirë pritjet e ngjarjeve të ardhshme të cilat besohet të jenë të arsyeshme në ato rrethana.

a) Ngarkesa e dëmtimit për humbjet nga kreditë

Banka rishikon portfolion e kredisë për të vlerësuar dëmtimin të paktën çdo tre muaj. Në përcaktimin nëse humbja nga dëmtimi duhet të regjistrohët në pasqyrën e të ardhurave, Banka bën gjykime nëse ka ndonjë të dhënë të dukshme që tregon se ka ulje të ndjeshme të rrjedhave të ardhshme të vlerësuar të parave nga një portfolio e kredive para se ulja të mund të identifikohet në një kredi specifike të asaj portfolio. Kjo dëshmi mund të përfshijë të dhëna që tregojnë se ka pasur një ndryshim negativ në statusin e pagesave të huamarrësve të Bankës, apo kushtet ekonomike lokale ose kombëtare që lidhen me mungesat në pasuritë e Bankës.

Menaxhmenti përdor vlerësime të bazuara në përvojën historike për humbjet nga pasuritë me karakteristika të rrezikut kreditor dhe dëshmi objektive të dëmtimit të ngjashme me ato në portfolio, kur caktojnë rrjedhat e ardhshme të pasasë. Metodologjia dhe supozimet e përdorura për të vlerësuar si shumë ashtu edhe kohën e rrjedhave të ardhshme të parave rishikohen rregullisht për të zvogëluar diferencat ndërmjet vlerësimeve të humbjes dhe përvojës aktuale të humbjes.

b) Dëmtimi i investimeve në dispozicion për shitje

Banka përcakton që investimet në dispozicion për shitje dëmtohen kur ka pasur ulje të rëndësishme ose të zgjatur të vlerës së drejtë nën koston e tyre. Ky përcaktim i asaj që është e rëndësishme ose e zgjatur kërkon gjykim. Në marrjen e këtij gjykimi, Banka vlerëson ndër të tjera, faktorët si luhatjet normale në çmimin e aksionit ku zbatohet. Përveç kësaj, dëmtimi mund të jetë i duhur, kur ka dëshmi të dëmtimit të gjendjes financiare të pranuesit të investimit, performancës së industrisë dhe sektorit, ndryshimet në teknologji, dhe rrjedhat operative dhe financuese të pasasë.

d) *Luhatjet e fundit në tregjet globale financiare*

Luhatshmëria e kohëve të fundit në tregjet financiare ndërkombëtare gjatë vitit 2013 kishte pak ndikim, por të kufizuar në sektorin financiar në Kosovë, pasi nuk kishte ekspozim të madh të sektorit jashtë vendit. Ekspozimi në letra me vlerë ishte i kufizuar kryesisht në vendet e OECD me vlerësim AA të të ardhurave tjera gjithëpërfshirëse. Sektori bankar i Kosovës ka vazhduar aktivitetet normale duke u mbështetur në kredidhënien në ekonominë e vendit, ndërsa si burim kryesor i financimit mbeten depozitat në Kosovë.

4. Menaxhimi i rrezikut financiar

4.1. Pasqyrë

Banka është e ekspozuar ndaj rreziqeve të mëposhtme nga shfrytëzimi i instrumenteve financiare:

- Rreziku kreditor
- Rreziku i likuiditetit
- Rreziku i tregut
- Rreziku operativ

Ky shënim paraqet informacion rreth ekspozimit të Bankës ndaj secilit nga rreziqet më lart, objektivat e Bankës, politikat dhe proceset për matjen dhe menaxhimin e rrezikut, dhe menaxhimin e kapitalit të Bankës.

Korniza e menaxhimit të rrezikut

Kontrollet e brendshme dhe mjete tjera të kontrollit të rrezikut të vendosura nga menaxhimi i rrezikut i Raiffeisen International mundësojnë menaxhimin e kontrolluar të rrezikut të Bankës. Mjetet e menaxhimit të rrezikut dhe kontrollit të rrezikut janë vendosur në bazë të njohurive të fundit për menaxhimin e rrezikut. Mjetet kryesore të menaxhimit të rrezikut janë miratuar nga Raiffeisen International dhe janë zbatuar për përdorim nga Banka.

Nga janari 2008, Banka ka vepruar në përputhje me dhe ka raportuar në bazë të kërkesave të Basel II në nivelin e Grupit që mbulon rrezikun kreditor dhe të tregut. Qasja e standardizuar është duke u zbatuar deri më tash. Transformimi i saj në qasjen më të fundit është në fazën e zhvillimit. Zbatimi i kërkesave të Basel II duhet të sigurojë një menaxhim më të mirë të kapitalit.

Mjedisi i thjeshtë financiar dhe i tregut në Kosovë lejon përdorimin e metodës së analizës të thjeshtë. Faktorët e ardhshëm më kompleksë dhe rreziqet në industrinë bankare do të përkrahen nga zhvillimi i metodave të reja për t'i menaxhuar më mirë ato.

Në bazë të politikave të Bankës, totali i pasurive të Bankës klasifikohet dhe analizohet si më poshtë:

- Analiza e pasurive bazuar në klasën e pasurisë/produktit (pasuritë klasifikohen në bazë të katalogut të produkteve të grupit);
- Analiza e pasurive bazuar në cilësinë kreditore (pasuritë klasifikohen në bazë të direktivave të Grupit);
- Analiza e pasurive në përputhje me bazën e matjes;
- Analiza e pasurive bazuar në vjetërsi, që do të thotë analiza e kryer për pasuritë që janë në vonesë por jo të dëmtuara;
- Analiza individuale e pasurive të përcaktuara si të dëmtuara nga faktorë dëmtimi;
- Analiza e pasurive bazuar në llojin e kolateralit dhe duke marrë parasysh shumën që vlerësohet se do të pranohet;
- Analiza e pasurive bazuar në përqendrimin e rreziqeve sipas industrisë/sectorit/segmentit/shumës së caktuar të ekspozimit.

4.2. Rreziku kreditor

Rreziku kreditor është rreziku i humbjes financiare për Bankën nëse klienti apo pala tjetër në një instrument financiar nuk arrin të përmbushë detyrimet kontraktuale, dhe shfaqet kryesisht nga kreditë dhe paradhëniet e bankës për klientët dhe bankat e tjera dhe letrat me vlerë të investimeve. Për qëllime të raportimit të menaxhimit të rrezikut, Banka i merr në konsiderim të gjitha elementet e ekspozimit ndaj rrezikut kreditor (si rreziku i mospërmbushjes së të obliguarit individual, rreziku i vendit dhe sektorit). Banka merr përsipër ekspozimin ndaj rrezikut kreditor që është rreziku që pala tjetër nuk do të jetë në gjendje të paguajë shumat e plota në kohën e duhur. Banka i strukturon nivelet e rrezikut kreditor që i merr përsipër duke vendosur limite në sasinë e rrezikut të pranuar në lidhje me një huamarrës dhe segment gjeografik apo industrial. Rreziqet e tilla monitorohen rregullisht dhe i nënshtrohen rishikimit mujor ose më të shpeshtë. Limitet në nivelin e rrezikut kreditor nga huamarrësi aprovohen nga Menaxhmenti.

Ekspozimi ndaj rrezikut kreditor menaxhohet përmes analizës së rregullt të aftësisë së huamarrësit dhe huamarrësve potencialë për të përmbushur detyrimet e pagesës së interesit dhe kapitalit dhe duke ndryshuar këto limite kreditimi, nëse duhet. Ekspozimi ndaj rrezikut të kredisë menaxhohet, pjesërisht, me marrjen e kolateralit dhe garancive të korporatave dhe atyre personale.

Ekspozimi maksimal i Bankës ndaj rrezikut kreditor pasqyrohet kryesisht në vlerat e pasurive financiare në pasqyrën e bilancit financiar. Ndikimi i kompensimit reciprok të mundshëm të pasurive dhe detyrimeve për të zvogëluar ekspozimin e mundshëm kreditor nuk është i rëndësishëm.

Rreziku kreditor për instrumentet financiare jashtë bilancit përcaktohet si mundësia e mbajtjes së humbjes si rezultat i asaj që një palë tjetër e instrumentit financiar nuk arrin të veprojë në përputhje me kushtet e kontratës. Banka përdor politikat e njëjta kreditore kur bën detyrimet e kushtëzuara ashtu siç bën për instrumentet financiare të bilancit nëpërmjet aprovimit të kredive të përcaktuara, limiteve të kontrollit të rrezikut dhe procedurave të monitorimit.

Banka mban lloje të ndryshme të kolateralit si siguri për rrezikun kreditor. Përveç kësaj, zbatohen metoda të tjera për përmirësimin e kreditit. Llojet kryesore të kolateralit janë të shënuara më poshtë:

- Prona (toka, shtëpitë)
- Apartamentet
- Automjetet
- Pajisjet
- Garanci personale

Kreditë dhe letrat me vlerë të dëmtuara

Kreditë dhe letrat me vlerë të dëmtuara janë kredi dhe letra me vlerë për të cilat Banka konstaton se është e mundshme që nuk do të jetë në gjendje të inkasojë tërë kapitalin dhe interesin e duhur sipas kushteve kontraktuale të marrëveshjes së kredisë/të letrave me vlerë.

Kreditë e vonuara por jo të dëmtuara

Kredi ku interesi kontraktual ose pagesat e kapitalit janë me vonesë por Banka beson se dëmtimi nuk është llogaritur si duhet në bazë të nivelit të sigurisë/kolateralit në dispozicion dhe/ose fazës së arkëtimit të shumës së kredisë ndaj bankës.

Kreditë me kushte të rinegociuara

Kreditë me kushte të rinegociuara janë kredi të cilat janë ristrukturuar për shkak të përkeqësimit të situatës financiare të huamarrësit dhe ku banka ka bërë lëshime të cilat nuk do të konsideronte përndryshe. Pasi kredia është ristrukturuar mbetet në të njëjtën kategori pavarësisht performancës së kënaqshme pas ristrukturimit.

Zbritjet për dëmtime

Banka vendos një zbritje për humbjet nga dëmtimi që përfaqëson vlerësimin e humbjeve që do të ndodhin të portfolion e saj kreditore. Elementet kryesore të kësaj zbritjeje janë një komponent i humbjes specifike që lidhet me ekspozimet individualisht të rëndësishme, dhe një pagesë kolektive për humbjet e kredisë e vendosur për grupet e pasurive homogjene në lidhje me humbjet që janë shkaktuar por nuk janë identifikuar në kreditë që janë objekt i vlerësimit individual për dëmtim.

Politika e shlyerjes

Banka shlyen gjendjen e kredisë (dhe zbritjen për humbjet nga dëmtimi) kur Komiteti i Bankës për Kredi Problematike konstaton se kreditë/letrat me vlerë janë të pa arkëtueshme. Ky vendim arrihet pas marrjes në konsideratë të informacionit të tillë si ndodhja e ndryshimeve të rëndësishme në situatën financiare të huamarrësit/emetuesit që huamarrësi/emetuesi më nuk mund të paguajë detyrimin, ose që të ardhurat nga kolaterali nuk do të jenë të mjaftueshme për të kthyer të gjithë ekspozimin.

The aging analysis on both past due and impaired and past due but not impaired loans and overdrafts is as follows:

| | Gjithsej shuma e bartur bruto | Pasuritë e vonuara por jo të dëmtuara | Pasuritë e dëmtuara individualisht (gjithsej shuma e bartur) | Provizionet individuale të humbjes nga kreditë | Provizionet e humbjes nga kreditë sipas portfolios | Vlera e drejtë e kolateralit |
|---|-------------------------------|---------------------------------------|--|--|--|------------------------------|
| 2013 | | | | | | |
| Klientët korporata | 267,962 | 65,835 | 35,887 | (13,498) | (4,116) | 218,706 |
| Klientët retail | 188,596 | 13,645 | 5,305 | (5,133) | (1,560) | 169,334 |
| Gjithsej kreditë dhe paradhëniet për klientët | 456,558 | 79,480 | 41,192 | (18,631) | (5,676) | 388,040 |
| 2012 | | | | | | |
| Klientët korporata | 244,128 | 75,514 | 25,936 | (11,592) | (6,200) | 175,539 |
| Klientët retail | 182,577 | 14,269 | 6,360 | (6,183) | (1,663) | 162,021 |
| Gjithsej kreditë dhe paradhëniet për klientët | 426,705 | 89,783 | 32,296 | (17,775) | (7,863) | 337,560 |

Analiza e vjetërsisë së kredive dhe mbitërheqjeve të vonuara dhe të dëmtuara dhe atyre të vonuara por jo të dëmtuara është si në vijim:

| 2013 | Me kërkesë dhe më pak se 1 muaj | Nga 1 deri 3 muaj | Nga 3 deri 12 muaj | Më shumë se 12 muaj | Gjithsej |
|---|--|--------------------------|---------------------------|----------------------------|-----------------|
| Kreditë dhe paradhëniet për klientët e vonuar por jo të dëmtuar | 6,358 | 16,604 | 22,001 | 34,517 | 79,480 |
| Kreditë dhe paradhëniet për klientët e vonuar dhe të dëmtuar | 22,527 | 764 | 2,733 | 15,168 | 41,192 |
| 2012 | Me kërkesë dhe më pak se 1 muaj | Nga 1 deri 3 muaj | Nga 3 deri 12 muaj | Më shumë se 12 muaj | Gjithsej |
| Kreditë dhe paradhëniet për klientët e vonuar por jo të dëmtuar | 9,239 | 18,390 | 15,520 | 46,634 | 89,783 |
| Kreditë dhe paradhëniet për klientët e vonuar dhe të dëmtuar | 15,211 | 1,372 | 3,968 | 11,745 | 32,296 |

Banka monitoron përqendrimin e rrezikut kreditor sipas sektorit. Analiza e përqendrimit të rrezikut kreditor më 31 dhjetor 2013 dhe 31 dhjetor 2012 për kreditë dhe paradhëniet për klientët e vonuar dhe të dëmtuar është dhënë më poshtë:

| 2013 | Me kërkesë dhe më pak se 1 muaj | Nga 1 deri 3 muaj | Nga 3 deri 12 muaj | Më shumë se 12 muaj | Gjithsej |
|---|--|--------------------------|---------------------------|----------------------------|-----------------|
| Klientët korporata | 21,493 | 546 | 2,013 | 11,835 | 35,887 |
| Klientët retail | 1,034 | 218 | 720 | 3,333 | 5,305 |
| Gjithsej kreditë dhe paradhëniet për klientët e dëmtuar | 22,527 | 764 | 2,733 | 15,168 | 41,192 |
| 2012 | Me kërkesë dhe më pak se 1 muaj | Nga 1 deri 3 muaj | Nga 3 deri 12 muaj | Më shumë se 12 muaj | Gjithsej |
| Klientët korporata | 14,239 | 1,198 | 3,007 | 7,492 | 25,936 |
| Klientët retail | 972 | 174 | 961 | 4,253 | 6,360 |
| Gjithsej kreditë dhe paradhëniet për klientët e dëmtuar | 15,211 | 1,372 | 3,968 | 11,745 | 32,296 |

Kreditë dhe paradhëniet për bankat

Ekspozimet ndërbankare monitorohen nga afër për çdo ditë nga Menaxhimi i Rrezikut dhe Departamenti i Thesarit. Banka kufizon depozitat e saj dhe transaksionet e tjera bankare vetëm në bankat lokale apo ndërkombëtare të sigurta. Para se të iniciohet një marrëdhënie afariste me një bankë të caktuar, menaxhmenti dhe departamenti i rrezikut kryejnë një analizë të gjendjes financiare të institucionit. Performanca financiare e palëve monitorohet vazhdimisht. Për më tepër, të gjitha bankat korrespondente, si dhe emetuesit e obligacioneve në të cilat Banka ka ekspozime të investimeve monitorohen vazhdimisht për vlerësimet e tyre nga agjencitë ndërkombëtare të vlerësimit si: Moody, Standard & Poor's (S&P) dhe Fitch.

Një funksion i pavarur nga departamenti i thesarit, zakonisht menaxhimi i rrezikut, duhet të monitorojë që ekspozimi ndaj të gjitha bankave nuk i kalon limitet rregullative ose limitet e brendshme të vendosura nga menaxhmenti i Bankës.

Në përputhje me rregulloren e re mbi ekspozimet e mëdha të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, bankat nuk duhet të kenë ekspozim total të rrezikut kreditor ndaj palëve të lidhura që tejkalon 15% të kapitalit rregullativ të Klasit I.

Kreditë dhe paradhëniet për bankat jepen pa kolateral. Tabela e mëposhtme paraqet llogaritë rrjedhëse të Bankës dhe depozitat e afatizuara në bankat korrespondente sipas rejtingut kreditor:

| Më 31 dhjetor | 2013 | 2012 |
|---------------|---------------|---------------|
| AAA | - | - |
| AA+ deri AA- | 68,235 | 58,423 |
| A+ deri A- | - | - |
| BBB+ deri B- | 5,806 | - |
| | 74,041 | 58,423 |

4.3 Rreziku i likuiditetit

Rreziku i likuiditetit është rreziku që Banka do të hasë vështirësi në përmbushjen e detyrimeve financiare. Banka ekspozohet ndaj kërkesave të përditshme mbi burimet e saj të parave të gatshme në dispozicion nga llogaritë rrjedhëse, depozitat me afat maturimi, kreditë e tërhequra dhe garancitë. Rreziku i likuiditetit menaxhohet nga Menaxhmenti i Bankës.

Banka mban pasuri afatmesme dhe afatgjata dhe për shkak të kushteve të tregut, financon portofolin e saj me borxh afatshkurtër. Në këtë proces, Banka trashëgon rrezikun e likuiditetit që lidhet me mospërputhjet e maturimit. Rreziqet nëse menaxhohen në mënyrë korrekte janë rreziqe të pranueshme. Banka lëshon pasuri afatgjata, siç janë kreditë dhe hipotekat PI, dhe këto portfolio financohen kryesisht nga depozitat me kërkesë dhe depozitat me afat deri në 1 vit. Menaxhmenti merr në baza ditore informacionin e raportit të likuiditetit të Bankës, dhe gjithashtu në baza javore pranon raportin e likuiditetit të renditur sipas segmentit të biznesit. Pasi që banka lëshon pasuri afatmesme dhe afatgjata, dhe i financon ato me borxh afatshkurtër dhe afatmesëm, ajo është e ekspozuar edhe ndaj rrezikut të normës së interesit.

Tabela e mëposhtme tregon pasuritë dhe detyrimet deri më 31 dhjetor 2013 dhe 2012 sipas maturitetit të mbetur kontraktual. Disa nga pasuritë megjithatë, mund të jenë të natyrës afatgjatë, për shembull kreditë vazhdojnë shpesh dhe prandaj kreditë afatshkurtra mund të ketë kohëzgjatje me afat më të gjatë.

| | Me kërkesë dhe më pak se 1 muaj | Nga 1 deri 3 muaj | Nga 3 deri 12 muaj | Më shumë se 12 muaj | Jo-specifike | Total |
|---|---------------------------------|-------------------|--------------------|---------------------|---------------|----------------|
| Pasuritë | | | | | | |
| Paraja dhe ekuivalentët e parasë dhe rezerva e detyrueshme e likuiditetit | 11,180 | - | - | - | 66,294 | 77,474 |
| Kreditë dhe paradhëniet për bankat | 63,194 | - | - | - | - | 63,194 |
| Kreditë dhe paradhëniet për klientët | 55,612 | 47,990 | 144,471 | 184,178 | - | 432,251 |
| Kreditë tjera | 734 | - | 2,273 | 16,315 | - | 19,322 |
| Letrat me vlerë për investime | 15,114 | 12,687 | 61,939 | 6,180 | - | 95,920 |
| Pasuri tjera | - | - | 1,889 | - | - | 1,889 |
| Gjithsej pasuritë financiare | 145,834 | 60,677 | 210,572 | 206,673 | 66,294 | 690,050 |
| Detyrimet | | | | | | |
| Depozitat nga klientët | 397,846 | 21,560 | 112,439 | 25,822 | - | 557,667 |
| Depozitat dhe huamarrjet nga bankat | 3,451 | - | 273 | 818 | - | 4,542 |
| Borxhi i varur | 283 | - | - | 19,000 | - | 19,283 |
| Detyrime tjera | - | - | 5,449 | - | - | 5,449 |
| Gjithsej detyrimet financiare | 403,596 | 20,621 | 117,614 | 45,110 | - | 586,941 |
| Neto pozicioni i diferencës më 31 dhjetor 2013 | (257,762) | 40,056 | 92,958 | 161,563 | 66,294 | 103,109 |

| | Me kërkesë dhe më pak se 1 muaj | Nga 1 deri 3 muaj | Nga 3 deri 12 muaj | Më shumë se 12 muaj | Jo-specifike | Total |
|---|---------------------------------|-------------------|--------------------|---------------------|---------------|----------------|
| Pasuritë | | | | | | |
| Paraja dhe ekuivalentët e parasë dhe rezerva e detyrueshme e likuiditetit | 12,668 | - | - | - | 73,550 | 86,218 |
| Kreditë dhe paradhëniet për bankat | 46,103 | - | - | - | - | 46,103 |
| Kreditë dhe paradhëniet për klientët | 35,785 | 58,521 | 128,461 | 178,299 | - | 401,066 |
| Kreditë tjera | 533 | - | 1,753 | 18,588 | - | 20,873 |
| Letrat me vlerë për investime | 17,338 | 17,270 | 4,216 | 25,277 | - | 64,102 |
| Pasuri tjera | - | - | 270 | - | - | 270 |
| Gjithsej pasuritë financiare | 112,427 | 75,791 | 134,700 | 222,164 | 73,550 | 618,632 |
| Detyrimet | | | | | | |
| Depozitat nga klientët | 366,590 | 23,205 | 104,151 | 19,923 | - | 513,869 |
| Depozitat dhe huamarrjet nga bankat | 522 | - | 2,600 | 1,091 | - | 4,213 |
| Detyrime tjera | - | - | 7,869 | - | - | 7,869 |
| Gjithsej detyrimet financiare | 367,112 | 23,205 | 114,620 | 21,014 | - | 525,951 |
| Neto pozicioni i diferencës më 31 dhjetor 2012 | (254,685) | 52,586 | 20,080 | 201,150 | 73,550 | 92,681 |

Analiza e maturimit të kredive për klientë bazohet në datat e mbetura të maturimit të marrëveshjeve të kredisë, që do të thojë duke marrë parasysh këstet në baza mujore.

Raportimi i likuiditetit në baza javore në nivel të segmentit të biznesit, monitorimi i raportit të pandryshueshmërisë ndaras për të gjitha segmentet e biznesit, limitet bankare të regjistrit dhe raportet të cilat matin rrezikun e interesit dhe diferencat, aktualisht janë mjetet e zbatuara për të menaxhuar dhe kufizuar rrezikun themelor për kryerjen e biznesit.

Rezervat e detyrueshme të likuiditetit janë të përfshira në kuadër të kategorisë “me kërkesë dhe më pak se një muaj”, sepse shumica e detyrimeve me të cilat lidhet kjo gjendje janë të përfshira edhe në këtë kategori.

Analiza e maturitetit për detyrimet financiare analizohet si në vijim:

- Në bazë të datës më të hershme kontraktuale të maturitetit– varianti i rastit më të keq;
- Në bazë të rrjedhave kontraktuale të parasë pa u skontuar;
- Përcaktimin e brezave kohorë;
- Rrjedhat e pritura të parasë përdoren si informata plotësuese.

Përputhja dhe/ose mospërputhja e kontrolluar e afateve të maturimit dhe normave të interesit të pasurive dhe detyrimeve është themelore për menaxhimin e Bankës. Është e pazakontë për bankat që të përputhen plotësisht pasi biznesi i kryer është shpesh me afat të pasigurt dhe i llojeve të ndryshme. Një pozicion i papërputhur potencialisht rrit përfitimin, por gjithashtu mund të rrisë rrezikun e humbjeve. Afati i maturimit të pasurive dhe detyrimeve dhe aftësia për të zëvendësuar detyrimet që bartin interes ndërsa ato vjetrohen me një kosto të pranueshme janë faktorë të rëndësishëm në vlerësimin e likuiditetit të Bankës dhe ekspozimin e tij ndaj ndryshimeve në interes dhe kursin e këmbimit.

Banka ka një mospërputhje të konsiderueshme të afatit të maturitetit të pasurive dhe detyrimeve me afat maturimi një vit. Kjo mospërputhje e likuiditetit lind për shkak të faktit se burimi kryesor i financimit të Bankës më 31 dhjetor 2013 ishin llogaritë e klientëve që kthehen sipas kërkesës dhe matura brenda më pak se një muaji. Menaxhmenti beson se, megjithë një pjesë të madhe të llogarive të klientëve që janë “sipas kërkesës”, diversifikimi i këtyre depozitave sipas numrit dhe llojit të depozituesve do të tregonte se llogaritë e këtyre klientëve japin një burim afatgjatë dhe të qëndrueshëm të financimit për Bankën.

Banka ka përmirësuar pozicionin neto përmes burimeve të tjera të financimit, të cilat ofrojnë financimin afatmesëm dhe ka për qëllim të vazhdojë përputhjen e maturitetit të pasurive me detyrimet në periudhat që do të vijin. Gjithashtu, Banka ka një marrëveshje të papërdorur të një mundësie për kredi, e cila do të ofrojë përkrahje në rast se ka nevojë për likuiditetit.

Shuma totale kontraktuese e mbetur e zotimeve për të dhënë kredi nuk paraqet domosdo kërkesa të ardhshme për para, pasi shumë prej këtyre zotimeve do të përfundojnë ose të përfundojnë pa u financuar.

4.4 Rreziku i tregut

Rreziku i tregut është rreziku që vlera e një investimi do të bjerë për shkak të lëvizjeve në faktorët e tregut. Katër faktorët standardë të rrezikut të tregut janë:

- Rreziku i ekuitetit ose rreziku që çmimet e aksioneve do të ndryshojnë.
- Rreziku i normës së interesit ose rreziku që normat e interesit do të ndryshojnë.
- Rreziku valutor ose rreziku që normat e valutës së huaj do të ndryshojnë.
- Rreziku i mallrave ose rreziku që çmimet e mallrave (d.m.th., drithërat, metalet etj.) do të ndryshojnë.

Banka merr përsipër ekspozimin ndaj rrezikut të tregut. Rreziku i tregut shfaqet nga pozicionet e hapura në normën e interesit dhe produktet valutore, të cilat janë të ekspozuara ndaj lëvizjeve të përgjithshme dhe specifike të tregut. Menaxhmenti vendos limitet në vlerën e rrezikut që mund të pranohet, që monitorohet në baza ditore. Megjithatë, përdorimi i kësaj qasjeje nuk i ndalon humbjet jashtë këtyre kufijve në rast të lëvizjeve më të mëdha të tregut.

Rreziku gjeografik

Përqendrimi gjeografik i pasurive dhe detyrimeve financiare të Bankës në datën 31 dhjetor 2013 dhe 2012 është dhënë më poshtë:

| | Kosovë | BE | Tjera | TotalAssets |
|---|-----------------|----------------|----------------|----------------|
| Paraja dhe ekuivalentët e parasë dhe rezerva e detyrueshme e likuiditetit | 66,294 | 6,474 | 4,706 | 77,474 |
| Kreditë dhe paradhëniet për bankat | - | 63,194 | - | 63,194 |
| Kreditë dhe paradhëniet për klientët | 432,251 | - | - | 432,251 |
| Kreditë tjera | - | 19,322 | - | 19,322 |
| Letrat me vlerë për investime | 7,738 | 75,730 | 12,452 | 95,920 |
| Pasuri tjera | 1,889 | - | - | 1,889 |
| Gjithsej pasuritë financiare | 508,172 | 164,720 | 17,158 | 690,050 |
| Detyrimet | | | | |
| Depozitat nga klientët | 515,026 | 19,994 | 22,647 | 557,667 |
| Depozitat nga bankat | 414 | 4,076 | 52 | 4,542 |
| Borxhi i varur | - | 19,283 | - | 19,283 |
| Detyrime tjera | 3,160 | 2,289 | - | 5,449 |
| Gjithsej detyrimet financiare | 518,600 | 45,642 | 22,699 | 586,941 |
| Neto pozicioni i diferencës më 31 dhjetor 2013 | (10,428) | 119,077 | (5,541) | 103,109 |

| | Kosova | BE | Tjera | TotalAssets |
|---|----------------|----------------|---------------|----------------|
| Paraja dhe ekuivalentët e parasë dhe rezerva e detyrueshme e likuiditetit | 73,549 | 9,686 | 2,983 | 86,218 |
| Kreditë dhe paradhëniet për bankat | - | 46,103 | - | 46,103 |
| Kreditë dhe paradhëniet për klientët | 401,066 | - | - | 401,066 |
| Kreditë tjera | - | 20,873 | - | 20,873 |
| Letrat me vlerë për investime | 5,988 | 41,497 | 16,617 | 64,102 |
| Pasuri tjera | 270 | - | - | 270 |
| Gjithsej pasuritë financiare | 480,873 | 118,159 | 19,600 | 618,632 |
| Detyrimet | | | | |
| Depozitat nga klientët | 482,641 | 12,412 | 18,816 | 513,869 |
| Depozitat nga bankat | 201 | 3,913 | 99 | 4,213 |
| Detyrimet tjera | 4,429 | 3,440 | - | 7,869 |
| Gjithsej detyrimet financiare | 487,271 | 19,765 | 18,915 | 525,951 |
| Neto pozicioni i diferencës më 31 dhjetor 2012 | (6,398) | 98,394 | 685 | 92,681 |

Rreziku valutor

Kjo është një formë e rrezikut që vjen nga ndryshimi në çmimin e një valute kundër një tjetre. Rreziku valutor menaxhohet përmes monitorimit të pozicioneve të hapura të FX (valutës së huaj). Këto pozicione janë të vendosura për pozicione ditore dhe gjithashtu veç e veç, për pozicionet brenda natës. Analiza e sensitivitetit i dorëzohet menaxhmentit në baza javore.

Banka merr përsipër ekspozimin ndaj efekteve të luhatjeve në kurset mbizotëruese të këmbimit në valutë të huaj në pozicionin e saj financiar dhe në rrjedhat e parave. Menaxhmenti vendos limitet mbi nivelin e ekspozimit sipas valutave dhe në total, të cilat monitorohen çdo ditë. Përdorimi i EURO-s në Kosovë dhe ekspozimi i kufizuar ndaj valutave të tjera do të thotë që ka pak nevojë për të përdorur instrumentet derivative.

Raporti i rrezikut të tregut që përfshin raportin e rrezikut të normës së interesit dhe raportin e valutës është hapur FX dërgohet te menaxhmenti në baza javore. Raporti përkatës përgatitet nga menaxhimi i rrezikut në RZB Vjenë bazuar në të dhënat që jepen nga burimet lokale të raportimit.

Tabela e mëposhtme jep përmbledhjen e ekspozimit të bankës ndaj rrezikut të këmbimit valutor të huaj në datën 31 dhjetor 2013 dhe 2012. Përfshirë në tabelë janë pasuritë dhe detyrimet financiare të bankës në vlera të librit, të kategorizuara sipas valutës dhe të konvertuara në '000 Euro.

| | EUR | USD | Tjera | TotalAssets |
|---|----------------|----------------|---------------|----------------|
| Paraja dhe ekuivalentët e parasë dhe rezerva e detyrueshme e likuiditetit | 65,331 | 5,735 | 6,408 | 77,474 |
| Kreditë dhe paradhëniet për bankat | 35,700 | 14,702 | 12,792 | 63,194 |
| Kreditë dhe paradhëniet për klientët | 432,251 | - | - | 432,251 |
| Kreditë tjera | 19,322 | - | - | 19,322 |
| Letrat me vlerë për investime | 83,468 | 12,452 | - | 95,920 |
| Pasuri tjera | 1,889 | - | - | 1,889 |
| Gjithsej pasuritë financiare | 637,961 | 32,889 | 19,200 | 690,050 |
| Detyrimet | | | | |
| Depozitat nga klientët | 504,963 | 34,642 | 18,062 | 557,667 |
| Depozitat nga bankat | 4,323 | 218 | 1 | 4,542 |
| Borxhi i varur | 19,283 | - | - | 19,283 |
| Detyrimet tjera | 5,449 | - | - | 5,449 |
| Gjithsej detyrimet financiare | 534,018 | 34,860 | 18,063 | 586,941 |
| Pozicioni neto i diferencës më 31 dhjetor 2013 | 103,943 | (1,971) | 1,137 | 103,109 |

| | EUR | USD | Tjera | Total |
|---|----------------|---------------|----------------|----------------|
| Assets | | | | |
| Paraja dhe ekuivalentët e parasë dhe rezerva e detyrueshme e likuiditetit | 72,458 | 4,744 | 9,016 | 86,218 |
| Kreditë dhe paradhëniet për bankat | 36,500 | 7,767 | 1,836 | 46,103 |
| Kreditë dhe paradhëniet për klientët | 401,066 | - | - | 401,066 |
| Kreditë tjera | 20,873 | - | - | 20,873 |
| Letrat me vlerë për investime | 47,485 | 16,617 | - | 64,102 |
| Pasuri tjera | 270 | - | - | 270 |
| Gjithsej pasuritë financiare | 578,652 | 29,128 | 10,852 | 618,632 |
| Detyrimet | | | | |
| Depozitat nga klientët | 469,321 | 29,150 | 15,398 | 513,869 |
| Depozitat nga bankat | 4,211 | 1 | 1 | 4,213 |
| Detyrimet tjera | 7,869 | - | - | 7,869 |
| Gjithsej detyrimet financiare | 481,401 | 29,151 | 15,399 | 525,951 |
| Neto pozicioni i diferencës më 31 dhjetor 2012 | 97,251 | (23) | (4,547) | 92,681 |

Analiza e sensitivitetit të valutës së huaj

Valutat e huaja ndaj të cilave Banka është e ekspozuar kryesisht janë Dollar amerikan (USD), Frang zviceran (CHF) dhe Funta britanike (GBP). Tabela e mëposhtme jep në detaje sensitivitetin e Bankës ndaj rritjes përkatëse dhe rënies në vlerën e euros kundrejt valutave të huaja. Përqindja e përdorur është norma e sensitivitetit e përdorur kur raportohet rreziku i valutës së huaj për personelin menaxhues kryesor dhe përfaqëson vlerësimin e menaxhmentit për ndryshimin e mundshëm në normat e këmbimit të valutës së huaj. Analiza e sensitivitetit përfshin vetëm artikujt monetarë të hapur në valutë të huaj dhe korrigjon konvertimin e tyre në fund të periudhës për një ndryshim përkatës në normat valutore. Analiza e sensitivitetit përfshin plasimet në bankat e tjera, paratë e gatshme në bankat korrespondente si dhe depozitat e klientëve, ku emërtimi i shumave është në valutë të ndryshme nga valuta e huadhënësit apo huamarrësit. Numri pozitiv më poshtë tregon rritje në fitim dhe ekuitet tjetër ku Euro forcohet me përqindjet përkatëse kundrejt valutës përkatëse. Për dobësimin përkatës të euros ndaj valutës përkatëse, do të kishte ndikim përafërsisht të barabartë dhe të kundërt në fitim dhe kapital tjetër, dhe gjendjet më poshtë do të ishin negative.

| | Dollar amerikan (USD) | | Franga zvicerane (CHF) | | Funta britanike (GBP) | |
|-------------------------|-----------------------|------|------------------------|------|-----------------------|------|
| | 2013 | 2012 | 2013 | 2012 | 2013 | 2012 |
| Normat e sensitivitetit | 5% | 7% | 2% | 1% | 3% | 3% |
| Fitimi dhe humbja | (101) | (5) | 1 | 0 | (1) | 0 |

Sipas mendimit të menaxhmentit, analiza e sensitivitetit nuk përfaqëson rrezikun e brendshëm të këmbimit valutor sepse viti dhe ekspozimi nuk pasqyrojnë ekspozimin gjatë vitit. Transaksionet në Dollar amerikan, Frang zviceran dhe Funta britanike nuk janë të shpeshta dhe janë vetëm për transaksionet dhe plasmanet në institucionet financiare jo të BE-së.

Rreziku i normës së interesit

Ky është rreziku që vlera relative e një pasurie që bart interes do të humbë në vlerë. Pasuritë e Bankës janë kryesisht në kredi afatmesme dhe afatgjata, dhe detyrimet janë kryesisht depozita afatshkurtra, prandaj kjo e ekspozon bankën ndaj mospërputhjeve të normës së interesit, dhe si pasojë diferencat përkatëse e ekspozojnë Bankën ndaj lëvizjeve të normës së interesit në treg.

Banka merr përsipër ekspozimin ndaj efekteve të luhatjeve në nivelet ekzistuese të normave të interesit të tregut në bilancin e saj financiar dhe rrjedhat e parave. Marzhat e interesit mund të rriten si rezultat i ndryshimeve të tilla, por mund të zvogëlohen ose të krijojnë humbje në rast se linden lëvizje të papritura.

Banka është e ekspozuar ndaj rrezikut të normës së interesit, kryesisht si rezultat i kredihënies me norma fikse të interesit, me shuma dhe për periudha të cilat ndryshojnë nga ato të depozitave me afat me norma fikse të interesit. Në praktikë normat e interesit në përgjithësi janë fikse për kredi afatshkurtra. Menaxhmenti vendos limitet e nivelit të mospërputhjes së normës së interesit për ndryshim të çmimit që mund të ndërmerret. Sipas kontratave të kundërkëmbimit të normave të interesit, Banka pajtohet të këmbëjë dallimin ndërmjet shumës fikse dhe asaj variabile të interesit të llogaritur mbi shumat konceptuale të kapitalit. Paraja në dorë dhe bilanci në BQK në të cilën nuk paguhet interes janë të përfshira në kolonën "pa interes" në tabelën e mëposhtme, si dhe depozitat pa interes të klientëve.

Për t'u mbrojtur për diferencat ndërmjet kredive fikse afatmesme dhe afatgjata në krahasim me ato variabile afatshkurtra dhe afatmesme, përdoret instrumenti derivativ financiar i quajtur kundërkëmbim i normës së interesit, ku Raiffeisen Bank në Kosovë është kryesisht paguese e anës së interesit të fiksuar, kurse pala tjetër është paguese e normës variabile, dhe ana variabile është indeksuar në EURIBOR 6 muaj, për të siguruar sensitivitet optimal.

Banka Raiffeisen në Kosovë zbaton menaxhimin aktiv të rrezikut për t'u mbrojtur kundër pozicioneve të rrezikut të tregut. Rreziku i normës së interesit është i mbrojtur nëpërmjet instrumenteve derivative financiare. Për të siguruar përfitimin afatgjatë për portfoliot ekzistuese të kredive, që maturohen në vitin 2013 deri në 15 vjet, këto pozicione janë të mbrojtura përmes kundërkëmbimit të normës së interesit. Pozicionet maten duke përdorur metodën e vlerës së pikëve bazë.

Tabela më poshtë jep përmbledhjen e ekspozimit të bankës ndaj rrezikut të normës së interesit. Të përfshira në tabelë janë pasuritë dhe detyrimet financiare të bankës në shumat e bartura, të kategorizuara sipas ndryshimit të çmimit ose datës së maturimit, cila është më e hershme.

| | Me kërkesë dhe më pak se 1 muaj | Nga 1 deri 3 muaj | Nga 3 deri 12 muaj | Më shumë se 12 muaj | Pa interes | Total |
|---|---------------------------------|-------------------|--------------------|---------------------|------------------|----------------|
| Pasuritë | | | | | | |
| Paraja dhe ekuivalentët e parasë dhe rezerva e detyrueshme e likuiditetit | 11,180 | - | - | - | 66,294 | 77,474 |
| Kreditë dhe paradhëniet për bankat | 62,861 | - | - | - | 333 | 63,194 |
| Kreditë dhe paradhëniet për klientët | 55,612 | 47,990 | 144,471 | 184,178 | - | 432,251 |
| Kreditë tjera | 734 | - | 2,273 | 16,315 | - | 19,322 |
| Letrat me vlerë për investime | 15,114 | 12,687 | 61,939 | 6,180 | - | 95,920 |
| Pasuri tjera | - | - | - | - | 1,889 | 1,889 |
| Gjithsej pasuritë financiare | 145,501 | 60,677 | 208,683 | 206,673 | 68,516 | 690,050 |
| Detyrimet | | | | | | |
| Depozitat nga klientët | 142,933 | 20,621 | 111,892 | 25,292 | 256,929 | 557,667 |
| Depozitat nga bankat | 980 | - | 273 | 818 | 2,471 | 4,542 |
| Borxhi i varur | 283 | - | - | 19,000 | - | 19,283 |
| Detyrimet tjera | - | - | - | - | 5,449 | 5,449 |
| Gjithsej detyrimet financiare | 144,196 | 20,621 | 112,165 | 45,110 | 264,849 | 586,941 |
| Neto pozicioni i diferencës më 31 dhjetor 2013 | 1,305 | 40,056 | 96,518 | 161,563 | (196,333) | 103,109 |

| | Me kërkesë dhe më pak se 1 muaj | Nga 1 deri 3 muaj | Nga 3 deri 12 muaj | Më shumë se 12 muaj | Pa interes | Total |
|---|---------------------------------|-------------------|--------------------|---------------------|------------------|----------------|
| Pasuritë | | | | | | |
| Paraja dhe ekuivalentët e parasë dhe rezerva e detyrueshme e likuiditetit | 12,668 | - | - | - | 73,550 | 86,218 |
| Kreditë dhe paradhëniet për bankat | 45,755 | - | - | - | 348 | 46,103 |
| Kreditë dhe paradhëniet për klientët | 35,785 | 58,521 | 128,461 | 178,299 | - | 401,066 |
| Kreditë tjera | 532 | - | 1,753 | 18,588 | - | 20,873 |
| Letrat me vlerë për investime | 17,339 | 17,270 | 4,216 | 25,277 | - | 64,102 |
| Pasuri tjera | - | - | - | - | 270 | 270 |
| Gjithsej pasuritë financiare | 112,079 | 75,791 | 134,430 | 222,164 | 74,168 | 618,632 |
| Detyrimet | | | | | | |
| Depozitat nga klientët | 155,952 | 23,205 | 104,151 | 19,923 | 210,638 | 513,869 |
| Depozitat nga bankat | 37 | - | 2,600 | 1,091 | 485 | 4,213 |
| Detyrimet tjera | - | - | - | - | 7,869 | 7,869 |
| Gjithsej detyrimet financiare | 155,989 | 23,205 | 106,751 | 21,014 | 218,992 | 525,951 |
| Neto pozicioni i diferencës më 31 dhjetor 2012 | (43,910) | 52,586 | 27,679 | 201,150 | (144,824) | 92,681 |

Tabela më poshtë jep përmbledhjen e normave efektive të interesit sipas valutave kryesore për instrumentet financiare monetare kryesore. Analiza është përgatitur duke përdorur normat vjetore efektive.

| Në përqindje | 2013 | | | | 2012 | | | |
|--------------------------------------|-------|-----|-------|-----|------|-----|-----|-----|
| | EUR | USD | CHF | GBP | EUR | USD | CHF | GBP |
| Pasuritë | | | | | | | | |
| Plasmanet pa afat në banka tjera | (0.0) | 0.0 | 0.0 | 0.4 | 0.1 | 0.2 | 0.0 | 0.4 |
| Depozitat me afat në banka tjera | (0.0) | 0.1 | (0.4) | 0.3 | 0.1 | 0.2 | N/A | 0.4 |
| Bonot qeveritare rendim. HTM | 2.2 | 1.7 | N/A | N/A | 1.8 | 1.1 | N/A | N/A |
| Bonot qeveritare rendim. AFV | 1.2 | 0.0 | N/A | N/A | 2.5 | 0.1 | N/A | N/A |
| Kreditë dhe paradhëniet për klientët | 10.3 | N/A | N/A | N/A | 10.7 | N/A | N/A | N/A |
| Kreditë tjera | 1.8 | N/A | N/A | N/A | 2.3 | N/A | N/A | N/A |
| Detyrimet | | | | | | | | |
| Llogaritë e klientëve | 0.3 | 0.0 | 0.0 | 0.0 | 0.4 | 0.0 | 0.0 | 0.0 |
| Depozitat me afat | 3.5 | 1.3 | 0.9 | 1.2 | 3.8 | 1.2 | 1.0 | 1.0 |
| Llogaritë e kursimit | 1.4 | 0.2 | 0.1 | 0.2 | 2.2 | 0.3 | 0.3 | 0.3 |

Nga perspektiva e menaxhimit të rrezikut dhe kontrollit, ka dy aspekte të rrezikut:

- Vlerësimi i rrezikut
- Kontrolli i rrezikut

Vlerësimi i rrezikut të interesit

Rreziku i normës së interesit matet duke përdorur metodën VaR (Vlerën në rrezik). Kjo metodë nënkupton një matje të një varianti duke përdorur kohëzgjatjen 10 ditë dhe intervalin e besueshmërisë 99%. VaR matet në stresin e 1bps ndryshim në lakoren e rendimentit. Ky variant supozon implikimin në fitim dhe humbje të Bankës, në rast se lakorja e rendimentit lëviz në një drejtim apo tjetrin për një pikë bazë ose për 0.01%. Rezultatet e analizës së sensitivitetit i paraqiten menaxhmentit në baza javore, dhe rishikohen në mënyrë të pavarur nga menaxhimi i rrezikut në RZB Vjenë.

Kontrolli i rrezikut të interesit

Mekanizmi i kontrollit të rrezikut të normës së interesit shfrytëzohet përmes raporteve ditore të vlerës në pikë bazë. Banka aktualisht ka limitin e VPB prej 55 mijë euro. Për qëllim të matjes së VPB, produktet e normës së administruar janë modeluar duke përdorur portfolio të përsëritur. Vlera e pikëve bazë matet për valutë dhe për brez kohor. Limitet vendosen edhe për çdo valutë dhe për periudha të ndryshme kohore.

4.5 Rreziku operacional

Përgjegjësia kryesore për zhvillimin dhe zbatimin e kontrolleve për të trajtuar rrezikun operacional i është dhënë menaxhmentit të lartë në çdo njësi biznesi. Kjo përgjegjësi përkrahet nga zhvillimi i standardeve të përgjithshme të Bankës për menaxhimin e rrezikut operacional në fushat e mëposhtme:

- kërkesat për ndarjen e detyrave, duke përfshirë edhe autorizimin e pavarur të transaksioneve
- kërkesat për barazimin dhe monitorimin e transaksioneve
- pajtueshmëria me kërkesat rregullative dhe ligjore
- dokumentimi i kontrolleve dhe procedurave
- kërkesat për vlerësimin periodik të rrezikut operacional dhe përshtatshmërisë së kontrolleve dhe procedurave për të trajtuar rrezikun e identifikuar
- kërkesat për raportimin e humbjeve operacionale dhe veprimet e propozuara korrigjuese
- zhvillimi i planeve kontingjente
- trajnimi dhe zhvillimi profesional
- standardet etike dhe të biznesit
- minimizimi i rrezikut, duke përfshirë dhe sigurimin kur kjo është efektive.

Pajtueshmëria me standardet e Bankës përkrahet nga një program kontrollesh periodike të ndërmarra nga auditimi i brendshëm. Rezultatet e kontrolleve të auditimit të brendshëm diskutohen me menaxhmentin e njësisë së biznesit të cilit i përkasin, përmbledhja i dërgohet komitetit të auditimit dhe menaxhmentit të lartë të Bankës.

4.6 Menaxhimi i rrezikut të kapitalit.

Kapitali rregullativ

Banka menaxhon kapitalin e saj për të siguruar se do të jetë në gjendje të vazhdojë afarizmin duke maksimizuar kthimin për aksionarët përmes optimalizimit të baraspeshës së borxhit dhe kapitalit. Strategjia e përgjithshme e Bankës mbetet e pandryshuar nga viti i kaluar. Struktura e kapitalit të Bankës përbëhet nga borxhi, që përfshin huamarrjet dhe ekuiteti që u takon pronarëve të kapitalit, i cili përfshin kapitalin e lëshuar dhe fitimet e mbajtura.

Kërkesat e kapitalit për rrezik operacional

Kërkesat e kapitalit për rrezikun operacional llogariten bazuar në rregulloren e BQK-së “për menaxhimin e rrezikut operacional”, duke përdorur metodën e treguesit themelor. Sipas metodës së treguesit themelor, kërkesa për kapital për rrezikun operacional është e barabartë me 15% (pesëmbëdhjetë për qind) e treguesit përkatës. Tregues përkatës është mesatarja gjatë tre viteve e shumës së të ardhurave neto nga interesat dhe të ardhurave neto jo nga interesat.

Raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit

Raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit është proporcioni i kapitalit rregullator ndaj pasurive të ponderuara sipas rrezikut, zërat jashtë bilancit dhe rreziqe të tjera, i shprehur në përqindje. Raporti minimal i kërkuar i mjaftueshmërisë së kapitalit është 8% për kapitalin e Klasit 1 dhe 12% për fondet vetanake totale. Banka ka përmbushur këto kërkesa rregullative gjatë vitit.

Pasuritë e ponderuara sipas rrezikut (RWA)

Pasuritë ponderohen në përputhje me kategoritë e gjera të rrezikut kombëtar, që u caktohet një peshë e rrezikut në përputhje me shumën e kapitalit që konsiderohet të jetë e nevojshme për t'i përkrahur ato. Gjashtë kategori të peshave të rrezikut (0%, 20%, 50%, 75%, 100%, 150%) zbatohen, për shembull paraaja dhe instrumentet e tregut të parasë kanë një peshë rreziku zero që do të thotë se nuk nevojitet kapital për mbajtjen e këtyre pasurive. Prona dhe pajisjet kanë një peshë 100% të rrezikut, që do të thotë se duhet të përkrahen nga kapitali (Klasi 1) i barabartë me 8% të vlerës së bartur.

Zotimet e kredive jashtë bilancit merren parasysh. Shumat ponderohen mandej sipas rrezikut duke përdorur të njëjtat përqindje si për pasuritë e bilancit të gjendjes.

| | 31 dhjetor 2013 | 31 dhjetor 2012 |
|---|--------------------|--------------------|
| Gjithsej pasuritë e ponderuara sipas rrezikut | 431,769 | 419,530 |
| Gjithsej ekspozimet e bilancit të ponderuara sipas rrezikut | 21,540 | 15,446 |
| Gjithsej pasuritë e ponderuara sipas rrezikut operacional | 51,101 | 55,476 |
| Total | 504,410 | 490,452 |
| Kapitali rregullativ (kapitali total) | 86,934 | 68,591 |
| Raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit (kapitali total) | 17.23% | 13.99% |

Raporti i modifikuar i mjaftueshmërisë së kapitalit është i barabartë me raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit.

Politika e Bankës është që të mbajë një bazë të fortë kapitali në mënyrë që të ruajë besimin e investitorëve, kreditorëve dhe tregut dhe të përkrahë zhvillimin e ardhshëm të biznesit. Ndikimi i nivelit të kapitalit në kthimin e aksionarëve njihet gjithashtu dhe Banka pranon nevojën për të mbajtur një ekuilibër ndërmjet kthimeve të larta që mund të jenë të mundshme me më shumë kredi dhe përparësisë dhe sigurisë së ofruar nga një pozicion i fortë i kapitalit.

Banka dhe aktivitetet e saj të rregulluara në mënyrë individuale janë në pajtueshmëri me të gjitha kërkesat e jashtme të kapitalit gjatë gjithë periudhës. Nuk ka pasur ndryshime materiale në menaxhimin e kapitalit të Bankës gjatë periudhës.

Raporti borxh/ekuitet

Komiteti i menaxhimit të rrezikut i bankës rishikon strukturën e kapitalit në bazë të vazhdueshme. Si pjesë e këtij shqyrtimi, komiteti shqyrton koston e kapitalit dhe rrezikun e lidhur me secilën klasë të kapitalit. Raporti borxh/ekuitet në vitin e përfunduar ishte si më poshtë:

| | 2013 | 2012 |
|-----------------------------------|------------|-----------|
| Borxhi | 23,357 | 3,728 |
| Ekuiteti | 106,968 | 99,236 |
| Neto raporti borxh/ekuitet | 22% | 4% |

5. Vlera e drejtë e instrumenteve financiare

Banka mat vlerën e drejtë duke përdorur hierarkinë e mëposhtme të vlerës së drejtë, e cila reflekton rëndësinë e të dhënave të përdorura në kryerjen e matjeve.

Niveli 1: të dhënat që janë çmimet e tregut të kuotuar (të parregulluara) në tregje aktive për instrumente identike.

Niveli 2: të dhënat tjera përveç çmimeve të kuotuar të përfshira në Nivelin 1 që janë të dukshme ose direkt (dmth. si çmime) ose tërthorazi (dmth. rrjedhin nga çmimet). Kjo kategori përfshin instrumente të vlerësuara duke përdorur: çmimet e kuotuar në tregjet aktive për instrumente të ngjashme; çmimet e kuotuar për instrumente identike ose të ngjashme në tregje që konsiderohen më pak aktive; ose teknika vlerësimi ku të gjitha të dhënat janë direkt ose indirekt të vëzhgueshme nga të dhënat e tregut.

Niveli 3: të dhënat që nuk janë të vëzhgueshme. Kjo kategori përfshin gjithë instrumentet për të cilat metoda e vlerësimit përfshin të dhëna që nuk bazohen në të dhëna të vëzhgueshme dhe të dhënat jo të vëzhgueshme kanë efekt të madh në vlerësimin e instrumentit. Kjo kategori përfshin instrumentet të cilat janë vlerësuar në bazë të çmimeve të kuotuar për instrumente të ngjashme për të cilat kërkohen korigjime të rëndësishme jo të vëzhgueshme ose supozime për të pasqyruar dallimet ndërmjet instrumenteve.

Teknikat e vlerësimit përfshijnë vlerën aktuale neto dhe modelet e skontuara të rrjedhave të parave, krahasimin me instrumente të ngjashme për të cilat ekzistojnë çmime tregu të vëzhgueshme, dhe metoda të tjera të vlerësimit. Supozimet dhe të dhënat e përdorura në metodat e vlerësimit përfshijnë normat e interesit pa rrezik dhe ato të krahasueshme, rendimentet e bonove (credit spread) dhe premiumet tjera të përdorura në llogaritjen e normave të skontuara, çmimet e bonove dhe kapitalit, normat e këmbimit në valutë të huaj, çmimet e aksioneve dhe çmimet e indeksit të kapitalit dhe luhatjet e pritshme të çmimeve dhe korrelacionet. Qëllimi i teknikave të vlerësimit është të arrijë matjen e vlerës së drejtë e cila pasqyron çmimin që do të merret për të shitur pasurinë ose që paguhet për transferimin e detyrimit në një transaksion të rregullt ndërmjet pjesëmarrësve të tregut në datën e matjes.

Paraja dhe ekuivalentët e parasë dhe rezerva e detyrueshme

Paraja dhe ekuivalentët e saj përfshijnë depozitat ndërbankare dhe zërat në proces të arkëtimit. Pasi këto gjendje janë afatshkurtra dhe me norma të ndryshueshme vlera e tyre e drejtë konsiderohet e barabartë me vlerën e tyre bartëse. Nëse të gjitha rënitë në vlerën e drejtë nën kosto konsiderohen të rëndësishme ose të zgjatura, Banka do të vuajë edhe 7,184 mijë euro humbje shtesë në pasqyrat e saj financiare 2013 (2012: 15.326 mijë euro), që është transferimi i rezervës së përgjithshme të vlerës së drejtë në fitim dhe humbje.

| Pasuritë | Vlera e drejtë | | Vlera e drejtë | |
|--------------------------------------|----------------|----------|----------------|----------|
| | Vlera bartëse | Niveli 2 | Vlera bartëse | Niveli 2 |
| Kreditë dhe paradhëniet për bankat | 63,194 | 63,194 | 46,103 | 46,103 |
| Kreditë dhe paradhëniet për klientët | 432,251 | 426,727 | 401,066 | 392,441 |
| Kredi tjera | 19,322 | 16,684 | 20,873 | 17,056 |
| Letrat me vlerë të investimeve | 95,920 | 96,074 | 64,102 | 60,744 |
| Detyrimet | | | | |
| Depozitat nga klientët | 557,667 | 556,866 | 513,869 | 513,576 |
| Depozitat nga bankat | 4,542 | 4,519 | 4,213 | 4,036 |

6. Paraja dhe ekuivalentët e parasë dhe rezerva e detyrueshme

| | 2013 | 2012 |
|---|---------------|---------------|
| Paraja në dorë | 30,251 | 37,140 |
| Gjendjet në BQK | 36,042 | 36,409 |
| Llogaritë korrespondente në banka tjera | 11,181 | 10,872 |
| Plasmanet e tregut të parasë | - | 1,797 |
| Total | 77,474 | 86,218 |

Paraja, ekuivalentet e saj dhe rezerva e detyrueshme përfshijnë një likuiditet të detyrueshëm rezervë në BQK prej 50,129 mijë Euro (31 Dhjetor 2012: 50,864 mijë euro). Kërkesa e rezervës së likuiditetit llogaritet në bazë të një mesatare të thjeshtë mbi një javë dhe duhet të mbahet si 10 për qind e depozitave bankare të pagueshme brenda një viti. Ajo përbëhet nga bilancet në BQK dhe 50% e parasë në dorë. Si e tillë gjendja mund të ndryshojë nga dita në ditë. Kjo gjendje përjashtohet nga paraja dhe ekuivalentët e parasë për qëllime të pasqyrës së rrjedhjes së parasë.

Më 31 dhjetor 2013 dhe 2012 paraja dhe ekuivalentët e parasë së bankës për qëllim të pasqyrës së rrjedhjes së parasë ishin si në vijim:

| | 2013 | 2012 |
|---|---------------|---------------|
| Gjithsej paraja dhe ekuivalentët e parasë dhe rezerva e detyrueshme | 77,474 | 86,218 |
| Minus: Rezerva e detyrueshme e likuiditetit | (50,129) | (50,864) |
| Paraja dhe ekuivalentët e parasë për qëllim të pasqyrës së rrjedhjes së parasë | 27,345 | 35,354 |

BQK-ja paguan interes në pasuritë mesatare të Bankës në BQK mbi 5% e bazës së depozitave të zbatueshme deri në shumën e kërkesës mesatare të rezervës minimale të likuiditetit. Më 31 dhjetor 2013, interesi është paguar në përqindje 0% në vit (31 Dhjetor 2012: 0.10% në vit).

7. Kreditë dhe paradhëniet për bankat

Depozitat me afat dhe depozitat pa afat investohen në bankat që operojnë në vendet e OECD. Depozita e garancisë përfaqëson plasmanët në Raiffeisen Bank Austria më 31 dhjetor 2013 dhe 2012.

Kreditë dhe paradhëniet për bankat përfshijnë të ardhurat nga interesi i përlogaritur në shumën prej 1 mijë euro (31 Dhjetor 2012: 1 mijë euro).

Depozitat e garancisë përfshijnë një shumë prej 333 mijë Euro më 31 dhjetor 2013 (31 Dhjetor 2012: 348 mijë Euro) të cilat paraqesin depozita të kufizuara me një palë të lidhur në raport me garancitë e lëshuara në emër të Bankës, për klientët e saj. Banka nuk ka të drejtë të përdorë këto fonde për qëllime të financimit të aktiviteteve të veta.

| | 2013 | 2012 |
|--|---------------|---------------|
| Depozitat me afat | 62,861 | 45,755 |
| Depozitat e garancisë | 333 | 348 |
| Gjithsej kreditë dhe paradhëniet për bankat | 63,194 | 46,103 |

8. Kreditë dhe paradhëniet për klientët

| | 2013 | 2012 |
|---|----------------|----------------|
| Klientët korporata | | |
| Kreditë aktuale dhe të ristrukturuara | 150,529 | 146,239 |
| Mbitërheqjet | 117,433 | 97,889 |
| | 267,962 | 244,128 |
| Klientët retail | | |
| Kreditë aktuale dhe të ristrukturuara | 178,039 | 172,288 |
| Mbitërheqjet | 10,557 | 10,288 |
| | 188,596 | 182,576 |
| Kreditë dhe paradhëniet për klientët | 456,558 | 426,704 |
| Minus: Provizioni i dëmtimit të kredive | (24,307) | (25,638) |
| Kreditë dhe paradhëniet për klientët, neto | 432,251 | 401,066 |

Kreditë dhe paradhëniet për klientët përfshijnë të ardhurat nga interesi i llogaritur në shumë prej 1,861 mijë euro (31 dhjetor 2012: 1,565 mijë euro).

Lëvizjet në provizionin për dëmtimin e kredive janë si më poshtë:

| | 2013 | 2012 |
|--|---------------|---------------|
| Provizioni për dëmtimin e kredive në fillim të vitit | 25,638 | 26,376 |
| Neto ngarkesa e provizionit për dëmtimin e kredive gjatë vitit | 5,456 | 5,295 |
| Të shlyera | (6,787) | (6,033) |
| Provizioni për dëmtimin e kredive në fund të vitit | 24,307 | 25,638 |

Më 31 dhjetor 2013, Banka ka 356 huamarrës (31 dhjetor 2012: 377 huamarrës) me shumë totale të kredive mbi 100 mijë euro. Shuma e përgjithshme e këtyre kredive është 281,240 mijë euro, ose 62% e portfolios bruto të kredive (31 Dhjetor 2012: 258,315 mijë euro ose 60% e portfolios bruto të kredive).

Përqendrimi i rezikut të sektorit ekonomik në portfolion e kredive për klientë është si në vijim:

| | 2013 | | 2012 | |
|--|----------------|-------------|----------------|-------------|
| | shuma | % | shuma | % |
| Tregtia | 191,786 | 41% | 156,298 | 37% |
| Individët | 182,166 | 40% | 171,596 | 40% |
| Prodhim, kimik dhe përpunimi | 34,974 | 8% | 31,307 | 7% |
| Shërbimet | 23,000 | 5% | 31,899 | 7% |
| Ndërtimtaria dhe shërbimet e ndërtimtarisë | 19,586 | 4% | 21,528 | 5% |
| Industria ushqimore dhe bujqësia | 2,339 | 1% | 1,888 | 0% |
| Tjera | 2,707 | 1% | 12,189 | 4% |
| Gjithsej kreditë dhe paradhëniet për klientët para provizionit për dëmtimin e kredive | 456,558 | 100% | 426,705 | 100% |

9. Kreditë tjera

| | 2013 | 2012 |
|-------------------------------|---------------|---------------|
| Kreditë tjera | 19,322 | 20,873 |
| Gjithsej kreditë tjera | 19,322 | 20,873 |

Portfolio e kredive të tjera përmban kredite e dhëna për klientët në vendet e tjera evropiane. Procesimi i kredisë dhe administrimi bëhet nga Raiffeisen Bank International në Vjenë dhe Raiffeisen Bank në Kosovë merr pjesë në marrëveshje vetëm përmes mjeteve të financimit. Këto kredi të dhëna për kompanitë me vlerësim të mirë kreditor janë pa rrezik, të garantuara nga RBI dhe nuk u janë ndarë provizione të rrezikut.

| Kreditë tjera – shpërndarja regjionale | 2013 | 2012 |
|--|---------------|---------------|
| Francë | 19,322 | 20,873 |
| Gjithsej kreditë tjera | 19,322 | 20,873 |

10. Letrat me vlerë të investimeve

| | 2013 | 2012 |
|---|---------------|---------------|
| Investimet e mbajtura deri në maturim (bono qeveritare) | 12,349 | 22,854 |
| Investime financiare në vlerë të drejtë (bono qeveritare) | 75,833 | 35,260 |
| Obligacionet e thesarit të Qeverisë së Kosovës | 7,738 | 5,988 |
| Investimet e ekuitetit në dispozicion për shitje | - | - |
| Gjithsej letrat me vlerë të investimeve | 95,920 | 64,102 |

Investimet e mbajtura deri në maturim më 31 dhjetor 2013 lidhen me obligacionet e Qeverisë së Republikës së Gjermanisë dhe Republikës së Polonisë me maturitet të mbetur që dallon ndërmjet 1 deri në 7 muaj. Investimet financiare me vlerë të drejtë më 31 dhjetor 2013 përfaqësojnë 0.1-1.5 vit, obligacione në EUR të lëshuara nga Gjermania, Republika e Francës, Austrisë, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Suedi, Danimarkë, Holandë, Finlandë dhe Republika e Kosovës (bonot e thesarit të qeverisë).

11. Investimi në vartës

| | 2013 | 2012 |
|---|------------|------------|
| Investimi në Raiffeisen Leasing Kosovo | 333 | 333 |
| Investimi në Raiffeisen Insurance Broker Kosovo | 3 | - |
| Gjithsej investimet në vartës | 336 | 333 |

Tabela më poshtë jep detajet e vartësve kryesorë të Bankës:

| Vartësi | Vendi kryesor i punës | Interesi i pronësisë | |
|------------------------------------|-----------------------|----------------------|------|
| | | 2013 | 2012 |
| Raiffeisen Leasing Kosovo | Kosovë | 70% | 70% |
| Raiffeisen Insurance Broker Kosovo | Kosovë | 70% | n/a |

Banka nuk ka kufizime të mëdha në aftësinë e saj për të marrë ose përdorur pasuritë e saj dhe për të zgjidhur detyrimet e saj ndryshe nga ato që rezultojnë nga kornizat mbikëqyrëse brenda të cilave veprojnë vartësit. Kornizat mbikëqyrëse kërkojnë nga vartësit të mbajnë nivele të caktuara të kapitalit rregullativ dhe pasurive likuide, të kufizojnë ekspozimin e tyre ndaj pjesëve tjera të grupit dhe të respektojnë treguesit e tjerë.

12. Pasuritë tjera

| | 2013 | 2012 |
|--|--------------|--------------|
| Parapagimet dhe paradhëniet për shërbime | 1,200 | 1,886 |
| Tarifat e arkëtueshme | 1,889 | 270 |
| Të arkëtueshmet tjera | 35 | 32 |
| Gjithsej pasuritë tjera | 3,124 | 2,188 |

13. Përmirësimet e pronës me qira, pajisjet dhe pasuritë e paprekshme

| | Përmirësimet e pronës me qira | Bankomatet, pajisjet tjera të bankës dhe zyres | Pajisjet harduerike | Pasuritë e paprekshme | Total |
|---|-------------------------------|--|---------------------|-----------------------|---------------|
| Kostoja më 31 dhjetor | | | | | |
| 2011 | 3,864 | 11,586 | 2,381 | 7,632 | 25,463 |
